
Raporti Vjetor 2023



otpbank



PËRMBAJTJA

4 Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

8 Qeverisja e Korporatës

16 Menaxhimi i Rrezikut Ligjor

19 Përputhshmëria dhe funksioni AML/CFT

21 Rezultatet financiare

22 Bankingu i Segmenteve

23 Bankingu i Korporatave

25 Bankingu Retail

28 Tregjet Globale

31 Menaxhimi i Riskut në OTP Bank Albania SH.A.

35 Projekte të Rëndësishme

37 Siguria Bankare

39 Departamenti i Burimeve Njerëzore

44 Përgjegjësia Sociale e Korporatës

55 Përvoja e Klientit

57 Informacion i Detajuar

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm



Bledar Shella
Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar i Bordit të Menaxhimit

Të dashur aksionerë, klientë dhe punonjës,

Viti 2023 ishte një vit stabiliteti, por edhe rritje e suksesi për Bankën OTP Albania duke demonstruar një fleksibilitet të pashembullt.

Ndihem tepër krenar që Banka OTP Albania i reflekton arritjet e saj në një kontekst tepër pozitiv, si tek klientët ashtu edhe tek partnerët.

Tashmë, ne jemi në rrugën e zhvillimit dhe progresit të vazhdueshëm e kjo pasqyrohet në konsolidimin tonë si një ndër bankat lider në industrinë financiare duke e shprehur ambicien e mëtejshme, jo vetëm në një kontekst lokal, por edhe si pjesë e një Grupi Bankar të një niveli Evropian me përvojë e stabilitet.

Të qëndrueshëm dhe reflektues mbi arritjet, ne vijojmë të përballemi me sfidat duke mbajtur të palëkundur përkushtimin ndaj klientëve, orientimin në zhvillimin e shërbimit dhe zgjidhjet inovative në përputhje me kërkesat e një tregu financiar dinamik.

Po ashtu, vlerat tona na udhëheqin në forcimin e harmonisë kulturore, e cila shprehet edhe në aspektin e shërbimit ndaj klientëve tanë, me të cilët bashkëndajmë sukseset.

Banka OTP Albania dominon tashmë territorin shqiptar, duke u renditur të parët për sa i përket numrit të ATM, me pothuajse 200 të tilla e duke vijuar punën për ofrimin e funksionaliteteve shtesë. Ndërkohë ne renditemi të katërtët për numrin e POS duke prezantuar në treg pajisjet më inovative të kryerjes së pagesave.

Gjithashtu OTP Bank Albania renditet e treta në tregun bankar shqiptar për kredidhënie në segmentin për individë dhe atë të biznesit. Në kontekstin e indikatorëve financiarë, Banka OTP Albania vijon të renditet e dyta ndër bankat më të mëdha që operojnë në treg, për kthim në kapital (ROE) duke theksuar pozicionin si një bankë e mirëmanaxhuar, me likuiditet dhe ardhmëri në ofertën për biznes. Raporti shpenzime / të ardhura për vitin fiskal 2023 është raportuar 44.7% duke vijuar të jetë një ndër bankat më eficiente në Shqipëri, ndërsa renditemi të tretët për përfitueshmëri.

Mbetem mirënjohës ndaj angazhimit dhe punës së përkushtuar të secilit punonjës. Le të vijojmë së bashku në forcimin e themeleve të bankës sonë dhe zhvillimit të inovacionit, duke pasur një qasje sa më optimiste për sfidat e reja që na presin, me synimin e vetëm për t'i qëndruar besnik klientëve tanë dhe më tej në konsolidimin e vlerave që na përfaqësojnë brenda dhe jashtë bankës.

Faleminderit,
Bledar SHELLA
Drejtor i Përgjithshëm

Çmimet







The Banker & Euromoney

Për Bankën OTP Albania, viti 2023 nuk përfaqëson vetëm një periudhë të realizimit të projektit më të madh, si ai i bashkimit me Alpha Bank Albania, por dhe i arritjes së rezultateve financiare të shkëlqyera të saj, si dhe një vit po aq i shënuar për sa i përket çmimeve të fituara.

Gjatë vitit 2023, Banka OTP Albania është nderuar me katër çmime prestigjioze si: "Banka e Vitit 2023" në Shqipëri, akorduar nga The Banker, "Çmimi i Ekselencës" për vitin 2023 akorduar nga Euromoney, si edhe vlerësimin e dyfishtë "Euromarket Leaders" për vitin 2023, "Market Leader Corporate Banking" dhe "Highly Regarded Digital Solutions" akorduar po ashtu nga Euromoney.

Pikërisht në vitin më të rëndësishëm dhe më të ngarkuar të saj, në aspektin e realizimit të projekteve dhe arritjeve këto vlerësime erdhën dhe u pozicionuan si një kurorë mbi sukseset e Bankës OTP Albania.
Vlen të theksohet se vlerësim më i ri "Euromarket Leaders", i akorduar për arritjet si në dimensionin e shërbimit të biznesit ashtu edhe në atë të digjitalizimit të shërbimeve bankare, përforcon rolin e Bankës OTP Albania si një bankë dinamike dhe ambicioze, e cila ka një vizion të qartë për sukses të mëtejshëm.
Vlerësime të këtij niveli të marra nga Banka OTP Albania nxjerrin në pah qasjen dhe prioritetin që ka Banka OTP Albania për të përfshirë dhe konsoliduar transparencën, dëgjimin e nevojave të klientit, ofrimin e zgjidhjeve të personalizuara dhe reagimin e shpejtë ndaj kërkesave të tyre.





Qeverisja e Korporatës




Përgjatë vitit 2023 struktura aksionare e Bankës OTP Albania sh.a, nuk pësoi ndryshime. Kapitali aksionar zotërohet 100% nga Grupi Hungarez OTP Bank plc.

Fokus i vazhdueshëm është treguar në rishikimin e politikave dhe rregulloreve, me qëllim krijimin e një drejtimi sa më efektiv dhe transparent në Bankë.

Asambleja e aksionarëve të Bankës, përveç mbledhjes së zakonshme vjetore për miratimin e pasqyrave të vitit financiar 2022, u mblodh edhe katër herë të tjera për miratimin e ndryshimeve në organet drejtuese të Bankës.
Këshilli Drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë, katër prej të cilëve të pavarur.
Në fund të vitit 2023, Këshilli Drejtues miratoi krijimin e Komitetit të Riskut të përbërë nga tre anëtarë. Komiteti i Riskut dhe Komiteti i Kontrollit raportojnë pranë Këshillit Drejtues, në frekuenca tre-mujore.

Bordi i Menaxhimit ka asistuar Drejtorin e Përgjithshëm në drejtimin efektiv të Bankës, sipas fushave respektive të kompetencës. Ai është mbajtur rregullisht duke mbajtur të informuar Drejtuesin Ekzekutiv dhe marrë vendime, kryesisht në lidhje me çështje të bashkimit të plotë të Bankës OTP Albania sh.a



MBLEDHJET E AKSIONERIT TË VETËM

Grupi Hungarez OTP Bank Plc, zotëron 100% të aksioneve të Bankës OTP Albania sh.a. Kapitali përbëhet nga aksione të zakonshme si vijon:

Kapitali	6.740.900.000
Kapitali i shlyer	6.740.900.000
Numri i aksioneve	67.409
Vlera nominale	100.000

Statuti i njeh aksionarit të drejta vote dhe dividend, në proporcion me pjesëmarrjen në kapital. Transferimi i aksioneve nuk është i kushtëzuar nga të drejta parablerje. Transferimi i pjesëmarrjeve influencuese në kuptim të Ligjit Për Bankat, është i kushtëzuar nga miratimet e autoriteteve rregullatore.
Asambléja e aksionarit të vetëm është mbledhur pesë herë gjatë vitit 2023, një mbledhje e zakonshme vjetore, si dhe katër mbledhje të jashtëzakonshme. Pas certifikimit të pasqyrave financiare vjetore SNFR të vitit 2023, Asamblea vendosi shpërndarjen e një dividendi të pagueshëm gjatë 2024.

KËSHILLI DREJTUES

Kultura e qeverisjes së korporatës për Bankën OTP Albania ka vijuar të jetë në përputhje me praktikat më të mira Evropiane dhe po ashtu në linjë me të gjithë kërkesat ligjore dhe rregullatore vendase.
Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues është bazuar në një analizë të thellë të kompetencave, kualifikimeve, diversitetit dhe përvojës, duke mbajtur gjithmonë në fokus edhe strategjinë e bankës. Procesi i emërimit, riemërimit dhe vlerësimit të administratorëve është kryer në përputhje me rregulloren e Bankës për "Fit and Proper", si dhe atë të Grupit OTP. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të Këshillit Drejtues kryhet duke u kujdesur të plotësohen kriteret sipas rregulloreve të Bankës së Shqipërisë.
Këshilli Drejtues i Bankës, në zbatim të funksionit të tij mbikëqyrës, është informuar rregullisht mbi aktivitetin e Bankës, rezultatet financiare dhe çështjet më të rëndësishme të identifikuara pas bashkimit teknik. Në zbatim të funksionit të tij si organ vendimmarrës, Këshilli Drejtues ka miratuar unanimisht pasqyrat financiare dhe buxhetin për vitin pasardhës, të gjitha kreditë të cilat tejkalojnë 10% të kapitalit rregullator të Bankës, planin e Kontrollit të Bankës, kuadrin rregullativ që prek aktivitetin e menaxhimit të riskut, likuiditetit dhe përputhshmërisë, riorganizimet në rrjetin e degëve, emërimet e administratorëve të Bankes, shpërblimin e performancës për pozicionet e identifikuara etj.
Drejtoria dhe Këshilli Drejtues besojnë se një qeverisje korporative e qënësishme dhe moderne janë jetike për ta bërë Bankën OTP Albania një ndër bankat më të besueshme në treg. Në funksion të përmirësimit të qeverisjes korporative dhe krijimin e një strukture të mirëfilltë për të mbikëqyrur dhe raportuar tolerancën/orkesin e riskut të bankës, Këshilli Drejtues vendosi që të krijojë edhe Komitetin e Riskut duke bërë kështu që aktualisht të raportojnë tek Këshillit Drejtues dy komitete: Komiteti i Kontrollit dhe Komiteti i Riskut.
Aktiviteti i Këshillit mbështetet jo vetëm në punën e Komiteteve të cilat raportojnë tek ai, por edhe në bashkëpunimin e ngushtë që Drejtoria e Bankës ka me Këshillin Drejtues. Komunikimi i vazhdueshëm që anëtaret e Këshillit Drejtues kanë me Drejtorinë dhe Bordin e Menaxhimit, ka ndihmuar në krijimin e një kulture besimi dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm.

Këshilli Drejtues mbikëqyr aktivitetin e Drejtorisë përmes përfshirjes në procesin e vendimmarrjes dhe miratimit të politikave/strategjisë së Bankës. Këshilli Drejtues vlerëson performancën e menaxherëve të lartë, në përputhje me politikat e shpërblimit, të miratuara prej tij.
Nga ana tjetër Këshilli Drejtues mban një linjë komunikimi të vazhdueshëm me aksionerin e vetëm të Bankës, jo vetëm përmes vlerësimit dhe miratimit të çështjeve të ndryshme, por edhe përmes raportimit.

ANËTARËSIA E KËSHILLIT DREJTUES

Përbërja e re e Këshillit Drejtues të Bankës u rishikua gjatë vitit 2023 duke kaluar nga pesë, në shtatë anëtarë. Kryetar i Këshillit Drejtues vijon të jetë Z. Gabor Kolics, me një eksperiencë të gjatë bankare dhe pjesë e organeve drejtuese dhe vendimmarrëse të kompanisë mëmë. Z. Kolics ka realizuar mbledhje me drejtuesit e lartë të Bankës, me qëllim përforcimin e ekspertizës në fusha të caktuara dhe sigurimin e një drejtimi dhe vendimmarrje të përshtatshme dhe të përgjegjshme. Zëvendës Kryetare e Këshillit Drejtues, u emërua Znj. Orsolya Kovács. Anëtarësia e re e Këshillit Drejtues është përzgjedhur me kujdes të veçantë, duke respektuar kriteret e pavarësisë dhe ekspertizës profesionale.

Anëtarësia e Këshillit Drejtues 2023
Struktura

Z. Gabor Kolics Kryetar	**Znj. Orsolya Kovács** Zv/Kryetar
Z. János Veres Anëtar	**Z. Armand Duka** Anëtar
Z. Ilir Ciko Anëtar	**Z. Stavri Pashko** Anëtar
Z. Örs Levente Szilágyi Anëtar	

Këshilli Drejtues ka patur një aktivitet intensiv vendimmarrje, ka realizuar 3 (tre) mbledhje fizike dhe 24 (njëzet e katër) me qarkullim dokumentacioni. Edhe pse vendimet e Këshillit Drejtues në Bankën OTP Albania janë të vlefshme kur shumica e anëtarëve janë në favor të vendimmarrjes, nëpërmjet diskutimeve dhe analizës është arritur që çdo vendim të ketë dakordësinë unanime të secilit prej anëtarëve.

Z. Gabor Kolics - Kryetar i Këshillit Drejtues
Z. Gabor Kolics, shtetas Hungarez, është i diplomuar nga Universiteti i Shkencave Ekonomike për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Ekonomiks. Z. Kolics punon në industrinë bankare që prej vitit 2004, vit në të cilin është bashkuar me Grupin OTP, si Analist i Riskut.
Prej vitit 2019, z. Gabor Kolics është drejtor menaxhues i Drejtorisë së Blerjeve dhe Integrimit të Grupit, përgjegjës për ekzekutimin e projekteve të Merger & Acquisition dhe integrimit të OTP Group, si dhe funksionin e kontrollit, raportimit dhe planifikimit në Divizionin e Bankave Tregtare.
Z. Kolics ka patur disa anëtarësime të tjera në filialet e Grupit OTP, duke përfshirë atë të CKB Bank (Mali i Zi) dhe DSK Bank (Bullgari). Në Dhjetor 2022, z. Gabor Kolics është kryetar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania.

Znj. Orsolya Csilla Kovács - Zv. Kryetare e Këshillit Drejtues
Znj. Orsolya Kovacs, shtetase Hungareze, është diplomuar në Universitetin Corvinus të Budapestit në profilin Menaxhim dhe Organizim. Znj. Kovacs punon në industrinë bankare që nga viti 2006, vit në të cilin është bashkuar me OTP Group si analiste financiare. Që nga viti 2022, znj. Orsolya Kovacs është Drejtoreshë e Departamentit të Analizës Strategjike përgjegjëse për mbështetjen e vendimmarrjes strategjike në OTP Group. Prej vitit 2022, znj. Kovacs është anëtare e Bordit Mbikëqyrës të OTP Home, një filial i OTP Group për ofrimin e ekosistemit të pasurive të paluajtshme në internet të OTP Group. Znj. Kovacs është anëtare e Këshillit Drejtues të OTP Albania që nga viti 2023.

Z. Stavri Pashko - Anëtar i Këshillit Drejtues
Z. Stavri Pashko, shtetas shqiptar, është i diplomuar në Universitetin e Torinos për Shkenca Strategjike dhe ka një diplomë MBA në Udhëheqje për Qëndrueshmëri. Z. Stavri Pashko ka një përvojë të thelluar në auditimin e brendshëm, menaxhimin e riskut, zhvillimin e biznesit dhe qëndrueshmërinë. Me mbi 17 vjet përvojë në industri, Z. Pashko e ka nisur eksperiencën e tij tek ProCredit Bank Albania dhe ish-Societe Generale Albania duke vijuar më pas në kompani ndërkombëtare si Telia Company, Volvo Group dhe Volvo Cars.
Gjatë gjithë karrierës së tij, z. Stavri Pashko ka treguar përkushtim ndaj profesionit të Audituesit. Ai është një nga themeluesit e Institutit Shqiptar të Audituesve të Brendshëm dhe ka kontribuar prej disa vitesh si anëtar i Komitetit Udhëheqës për Institutin Global të Audituesve të Brendshëm, me seli në SHBA.
Në vitet e fundit, z. Pashko ka vepruar si Kryetar i Komitetit të Kontrollit dhe Anëtar i Këshillit Drejtues i ish-Alpha Bank Albania. Aktualisht, z. Pashko është Zhvillues i Biznesit të Qëndrueshmërisë në Volvo Cars, i fokusuar në sigurimin e pajtueshmërisë me qëndrueshmërinë dhe integrimin e praktikave të qëndrueshmërisë, në operacionet e biznesit global.
Duke filluar nga Maji, 2023 z. Pashko është anëtar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania.

Dr. Janos Veres – Anëtar i Këshillit Drejtues
Dr. Janos Veres, një shtetas Hungarez, është diplomuar në Inxhinieri në Fakultetin e Shkencave Bujqësore të Universitetit të Debrecenit (Hungari) dhe ka kryer studimet e doktoraturës për Ekonomi në Universitetin Karl Marx, Budapest (Hungari). Dr. Veres ka një përvojë 32 vjeçare në sektorët publikë dhe privatë. Nga viti 1997 deri në vitin 2002, Dr. Veres ka qenë Kryetar i Dhomës së Tregtisë për rajonin Szabolcs-Szatmár-Bereg.
Ai ka qenë një anëtar i zgjedhur i Asamblesë Kombëtare/Parlamentit të Hungarisë (1994-2014) dhe përgjatë viteve Dr. Veres ka zhvilluar një karrierë në politikë ku ia vlen të përmenden pozicionet si: Sekretar i Shtetit në Ministrinë e Financave (2003-2004), Sekretari i Shtetit në Zyrën e Kryeministrit (2004-2005) dhe Ministrër i Financave (2005-2009). Në pozicionin e tij si Ministër, Dr. Veres ka qenë përgjegjës për çështjet rregullatore, mbikëqyrëse dhe monitoruese

të sektorit bankar dhe të institucioneve të tjera financiare, për çështjet e taksimit të ekonomisë, për të gjithë fushën e buxhetit dhe manaxhimit të aseteve shtetërore. Ai gjithashtu përgatiti dhe zbatoi një skemë të suksesshme për të manaxhuar ndikimet e krizës financiare të vitit 2008. Dr. Janos Veres është zgjedhur Kryebashkiak i vendlindjes së tij, Nyírbátor (2002 - 2003) dhe tani vazhdon të japë kontributin e tij të vyer në Këshillin Bashkiak të Nyirbatorit.
Sa lidhur me karrierën e tij akademike, në vitin 2009 Dr. Veres ka qenë Docent në Universitetin e Debrecen dhe është autor i shumë botimeve në fushën financiare dhe ekonomike për Universitetet Hungareze dhe të huaja. Duke filluar nga Mars, 2019 Dr. Veres është anëtar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania.

Z. Armand Duka - Anëtar i Këshillit Drejtues
Z. Armand Duka, shtetas Shqiptar, është diplomuar në Universitetin e Tiranës (Shqipëri), Dega e Ekonomisë për Industri në vitin 1986. Z. Duka ka filluar karrierën në profesionin e Ekonomistit në Parkun e Mallrave në Burrel në vitet 1986-1990. Gjatë viteve 1990-1991, z. Duka ka ushtruar profesionin e tij si ekonomist në parkun e mallrave të eksportit në Durrës. Duke filluar nga viti 1993, z. Armand Duka është sipërmarrës në sektorë të tjerë privatë, zotërues dhe aksionar në disa biznese të mirënjohura, ku rikonfirmon kështu aftësitë e tij shumë të mira manaxhuese dhe drejtuese.
Z. Armand Duka është zgjedhur President i Federatës Shqiptare të Futbollit në vitin 2002, post të cilin e mban dhe aktualisht duke u rizgjedhur në vitet 2006-2010-2014-2018.
Ndër vite, z. Armand Duka është nderuar me disa tituj, ku mund të përmendim: titullin "Qytetar Nderi" (1998) akorduar nga Bashkia e Shijakut dhe titujt "Nderi i Qytetit" (2001), "Simbol i Qytetit të Durrësit" (2002) dhe "Dyrrah – 3000" (2003) akorduar nga Bashkia e Qytetit të Durrësit dhe Shoqata "Durrësi". Në vitin 2010, Presidenti i Republikës së Shqipërise, Z. Bamir Topi e dekoron me titullin e lartë "Naim Frashëri" të Klasit të Parë, për kontribut të shquar, në drejtimin dhe zhvillimin e futbollit shqiptar. Në vitin 2019, Z. Duka akordohet me titullin "Konsull nderi i Hungarisë" për Republikën e Shqipërisë.
Duke filluar nga Tetor, 2019 z. Armand Duka është anëtar i Këshillit Drejtues i Bankës OTP Albania.

Z. Ilir Ciko - Anëtar i Këshillit Drejtues
Z. Ilir Ciko është një ekonomist shqiptar i cili ka një Master në Administrim Publik nga Universiteti i Harvardit dhe një MBA nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Nebraskës. Z. Ciko ka përvojë të konsiderueshme dhe angazhim afatgjatë në menaxhimin e institucioneve dhe ekipeve private e publike, si dhe në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të mëdha dhe buxheteve. Përvoja e tij 27 vjeçare përfshin kërkime dhe konsulenca të ndryshme zhvillimi për organizata ndërkombëtare, kontribut si ekspert në administratën publike, duke përfshirë pozicionin e zëvendësministrit të ekonomisë (2003-2005) dhe aktivitet të vazhdueshëm akademik që nga viti 2004 si pedagog në Universitetin e New York në Tiranë dhe aktualisht në Institutin Kanadez të Teknologjisë. Për shumë vite, Z. Ciko ka shërbyer në bordet e korporatave më të mëdha publike dhe private në Shqipëri.
Gjatë periudhës 2012 – 2022 ka shërbyer si anëtar i pavarur i bordit drejtues të ish-Alpha Bank Albania dhe anëtar i komitetit të riskut të bankës. Z. Ciko ka kontribuar në përgatitjen e dokumenteve të dukshme të zhvillimit të qëndrueshëm dhe strategjik për Shqipërinë, duke përfshirë së fundmi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 dhe shumë raporte dhe dokumente politikash që lidhen me rrugën e Shqipërisë në arritjen e Axhendës 2030 SDGs. Ai ka qenë autor i shumë artikujve dhe publikimeve mbi një spektër të gjerë çështjesh ekonomike në Shqipëri dhe rajon dhe ka qenë anëtar akademik i FMN-së në Takimet Pranverë të Bankës Botërore dhe FMN-së. Ai është bashkëthemelues, dhe president i Klubit të Harvardit të Shqipërisë për periudhën 2014-2020.

KOMITETIT I KONTROLLIT

Komiteti i Kontrollit raporton pranë Këshillit Drejtues. Krijuar në përputhje me Ligjin dhe aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë:
Anëtarësia e Komitetit të Kontrollit 2023:



Gjatë vitit 2023 Komiteti i Kontrollit është mbledhur 3 herë me prezencë fizike dhe 3 herë me qarkullim dokumentacioni, me fokus miratimin e politikave të kontrollit të brendshëm, mbikëqyrjen e raporteve të tij, miratimin e pasqyrave financiare dhe opinioneve të ekspertëve të jashtëm për vitin 2022. Komiteti sigurohet për zbatimin e politikave kontabël dhe financiare dhe informon Këshillin Drejtues për çdo problematikë të evidentuar. Aspektet financiare dhe ato të kontrollit ishin në linjë me aktet nënligjore dhe pritshmëritë e Grupit mëmë.
Përbërja e Komitetit të Kontrollit ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2023. Z. Zoltan Molnar është anëtari i ri i emëruar në Komitetin e Kontrollit. Gjithashtu u emërua dhe aprovua nga Banka e Shqipërisë dhe Kryetari i ri i këtij Komiteti, Z. Stavri Pashko me eksperiencë të gjatë në fushën e auditimit të brendshëm, menaxhimit të riskut, zhvillimit të biznesit dhe qëndrueshmërisë.

KOMITETI I RISKUT

Në dhjetor të vitit 2023 Këshilli Drejtues mori vendim për krijimin e Komitetit të Riskut.

Ky komitet i specializuar u krijua për të mbështetur dhe këshilluar Këshillin Drejtues, duke marrë në konsideratë të gjithë llojet e rreziqeve dhe për t'u siguruar që ata janë në linjë me strategjinë e biznesit, objektivat, kulturën dhe vlerat e bankës.

Krijuar në përputhje me Ligjin dhe aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, Komiteti i Riskut përbëhet nga 3 (tre) anëtarë:



Komiteti mbështet Këshillin Drejtues në arritjen e objektivave të mëposhtme:

• Promovimin e një kulture të shëndoshë rreziku në të gjitha nivelet në të gjithë Bankën, duke promovuar ndërgjegjësimin për rrezikun dhe duke inkurajuar komunikimin në të gjithë organizatën;
• Mbikëqyrjen që strategjitë e menaxhimit të rrezikut dhe kapitalit të korrespondojnë me objektivat e biznesit të Bankës;

• Mbikëqyrjen që Banka të miratojë një deklaratë dhe kornizë të mirëpërcaktuar të oreksit të rrezikut, të cilat perfshijnë të gjithë organizatën dhe percaktohen në kufij për shtet, sektor dhe njësi biznesi. Komiteti mbikëqyr që kuadri i oreksit të rrezikut të përputhet plotësisht me strategjinë e Bankës dhe të Grupit, procesin e buxhetit, planifikimin e kapitalit dhe likuiditetit dhe kuadrin e shpërblimit;
• Mbikëqyrjen e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të politikave dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut të Bankës;
• Mbikëqyrjen e zbatimit të masave efektive lehtësuese dhe korrigjuese, në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, sipas rastit;
• Mbikëqyrjen që të ketë një nivel adekuat komunikimi për çështjet e menaxhimit të rrezikut ndërmjet Auditorit të Brendshëm, Auditorëve të Jashtëm, Autoriteteve Mbikëqyrëse, Komitetit të Auditimit dhe Bordit Mbikëqyrës.

Komiteti mblidhet të paktën një herë në çdo tremujor. Menaxheri i Divizionit të Riskut është pjesëmarrës i rregullt në mbledhjet e komitetit.
Rregullorja e funksionimit të Komitetit të Riskut është miratuar nga Këshilli Drejtues në qershor të vitit 2024.

Qeverisja e korporatës gjatë vitit 2024 do të vijojë të jetë në prioritetet tona. Fokusi ynë do të jetë rishikimi i drejtimit të Bankës në mënyrë sa më transparente, duke rritur numrin e komiteteve raportuese në Këshillin Drejtues, rishikimin e komiteteve të brendshme si dhe të qeverisjes së korporatës.
Ne do të vazhdojmë të punojmë gjatë vitit 2024 për të siguruar informacion të rregullt tek aksionari ynë i vetëm dhe do të ndërtojmë strategji në përputhje me udhëzimet e tyre dhe besimin e klientëve tanë.

Menaxhimi i Rrezikut Ligjor



Gjatë vitit 2023 Departamenti Ligjor ka menaxhuar rrezikun ligjor duke u kujdesur të trajtojë aspektet ligjore të çdo projekti apo iniciative të re, duke rishikuar rreziqet ligjore të procesit të kredidhënies përmes ndjekjes së proceseve gjyqësore si dhe zbatimit rigoroz të kuadrit rregullativ.

Fokusi ka qenë përmirësimi i shërbimeve duke mbajtur nivele të ulëta të rrezikut ligjor dhe siguruar përputhshmërinë e plotë të aktivitetit me Ligjin shqiptar, rregulloret e Grupit OTP, rregulloret e brendshme dhe praktikat më të mira evropiane.

PËRMBYLLJA E PROCESIT TË BASHKIMIT TË PLOTË MIDIS BANKËS OTP ALBANIA SH.A. DHE ISH-ALPHA BANK ALBANIA SH.A.

Aktiviteti ligjor ka patur në fokus për vitin 2023 realizimin me sukses të bashkimit teknik të Bankës OTP Albania me Bankën e përthithur ish-Alpha Bank Albania dhe përmbylljes së plotë të të gjithë hapave të procesit të bashkimit, midis dy bankave. Është zbatuar në mënyrë rigoroze kuadri ligjor, ku përfshihen: kërkesat rregullatore, detyrimi për njoftimin e Autoriteteve Mbikqyrëse, si dhe kujdesi për transparencë maksimale në komunikim me klientët e Bankës, mbi këtë proces të rëndësishëm.

Përmbyllja e procesit të plotë të bashkimit midis Bankave rezultoi e suksesshme dhe konform parashikimeve të legjislacionit të posaçëm.

ZGJERIMI I LICENCËS SË BANKËS ME SHËRBIME SHTESË

Me vendimin nr. 134 datë 28.07.2023 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Banka OTP Albania u licencua për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime, në klasat e jetës dhe jo-jetës.

Për realizimin e këtij objektivi u ndoqën të gjithë hapat dhe procedurat ligjore që kërkon legjislacioni i aplikueshëm duke rezultuar në pajisjen me sukses të Bankës me një licencë, e cila lejon zgjerimin e veprimtarisë së saj në fushën e sigurimeve.

Me vendimin nr. 184 datë 27.10.2023 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Banka OTP Albania përmirësoi licencën e saj si shoqëri komisionere me nr. 3, datë 29.12.2021 duke shfuziquar kufizimet në lidhje me titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të cilat përmbajnë në strukturën e tyre një instrument derivativ, apo që konsiderohen instrumente komplekse.

Me ndjekjen e hapave ligjorë të nevojshëm për përmirësimin e licencës, Banka bëri të mundur lëshimin e një Bondi korporativ në vlerën 7.6 Milionë Euro.

Struktura ligjore asistoi për të mundësuar ofrimin e këtij produkti tek klientët, në përputhje me kërkesat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

SHTIMI I PRODUKTEVE BANKARE SIPAS KËRKESAVE TË AUTORITETETEVE APO NEVOJËS SË TREGUT

LLOGARIA ME SHËRBIME BAZIKE

Me publikimin e projektligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike", lindi nevoja për realizimin e një produkti të ri në Bankë, i cili do t'i ofrohej një kategorie të posaçme klientësh, duke zbatuar kushtet dhe normat e parashikuara në këtë ligj.

Struktura ligjore është angazhuar në fazën paraprake të vlerësimit të projekt ligjit si dhe në implementimin në Bankë duke mundësuar ofrimin e ketij produkti tek klientët.

FINANCIMI I PROJEKTEVE START UP QË KONSISTOJNË KRYESISHT NË PRODHIMIN E ENERGJISË "GREEN"


Gjatë vitit 2023 Banka ka mundësuar financimin e "Start-up"-eve me objekt prodhimin e energjisë elektrike në mënyra alternative dhe kryesisht nëpërmjet centraleve gjenerues të energjisë fotovoltaike. Struktura ligjore ka dhënë asistencën e saj për të mbështetur realizimin e projekteve të tillë, për të cilët edhe kuadri ligjor ka vakume.

NDJEKJA E PROCESEVE GJYQËSORE

Me realizimin e bashkimit të plotë ligjor në vitin 2023, Banka ka menaxhuar në mënyrë të suksesshme ndjekjen dhe trajtimin e proceseve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit. Struktura ligjore ka përfaqësuar interesat më të larta të Bankës, duke monitoruar dhe propozuar rast pas rasti edhe provigjionimin e çështjeve, në përputhje me rregulloret në fuqi.

IMPLEMENTIMI I NDRYSHIMEVE RREGULLATORE

Viti 2023 ka qënë i karakterizuar nga disa ndryshime rregullatore. Janë monitoruar risitë ligjore që kanë pasur një impakt për aktivitetin bankar dhe janë implementuar ne kohë kërkesat rregullatore. Ndryshimet ligjore janë implementuar në rregulloret e brendshme të Bankës, duke siguruar përputhshmëri të plotë në datën e hyrjes në fuqi.



Përputhshmëria dhe funksioni AML/CFT

Si rezultat i bashkimit ligjor të OBA me Alpha Bank më 30 Nëntor 2022, në 2023 funksioni i Përputhshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave (PPP) pësoi një transformim thelbësor.

U krijua Departamenti i Përputhshmërisë dhe PPP-së, i cili u zhvillua në dy sektorë të veçantë, përkatësisht Përputhshmërisë dhe PPP. Departamenti i Përputhshmërisë dhe PPP raporton direkt tek Drejtori i Përgjithshëm, i cili nga ana e tij raporton në Bordin e Drejtorëve të Bankës. Gjithashtu, Departamenti i Përputhshmërisë dhe PPP raporton në Komitetin e Kontrollit të Brendshëm dhe Komitetin e Auditimeve dhe Llogarive, në bazë tremujore. Përputhshmëria mban gjithashtu një linjë të drejtpërdrejtë raportimi në Drejtorinë e Përputhshmërisë në selinë qendrore duke raportuar në baza mujore tek korrespondentët e Grupit, si dhe kolegët e tjerë të Drejtorisë, për çështje specifike.

Funksioni i Përputhshmërisë dhe PPP përbën një parim themelor të OTP Bank Albania duke garantuar drejtimin e veprimtarisë së Bankës në përputhje të plotë me ligjet në fuqi, rregullat, rregulloret dhe standardet profesionale. Edhe gjatë vitit 2023, ka vijuar të parandalojë dhe zbusë rreziqet e Perputhshmërisë & PPP/LFT për të garantuar funksionimin e sigurtë të Bankës.

Anëtarët e bordit, menaxhimi i Bankës dhe të gjithë punonjësit tanë janë përgjegjës që t'i përmbahen kuadrit rregullator të përputhshmërisë në fuqi dhe të respektojnë parimet e Bankës dhe të Grupit.

Ky vit solli sfida shtesë për shkak të bashkimit të OTP Bank Albania me Alpha Bank Albania. Mbështetja e vazhdueshme dhe pjesëmarrja aktive në të gjitha momentet e shkrirjes teknike, duke përfshirë dhënien e opinionit, testimin dhe vlerësimin e KPI-ve, ishin të nevojshme për të siguruar një periudhë të qetë tranzicioni.

Siguria Financiare

Aktiviteti bankar është i ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme të krimit financiar, siç janë pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe shkelja e sanksionve, por edhe ndaj aktivitete të tjera kriminale, si mashtrimi, ryshfeti dhe korrupsioni.

Në mënyrë që të parandalohen dhe menaxhohen më mire risqet e mësipërme, por gjithashtu për të qënë në përputhje me detyrimet e ligjore dhe rregullatore, OTP Bank Albania ka krijuar një program të plotë përputhshmërie, i cili rishikohet në bazë vjetore. Thelbi i tij përbëhet nga të gjitha politikat dhe proçedurat e nevojshme të cilat u përshtatën plotësisht me ndryshimet në mjedisin ligjor lokal dhe kërkesave të Grupit dhe planet e veprimit për masat korrigjuese.

Nëpërmjet sesioneve tona të trajnimit dhe ndërgjegjësimit, ne kemi siguruar që i gjithë stafi i bankës të kuptojë dhe të zbatojë kuadrin rregullator në fuqi për zbutjen e rrezikut të PPP/LFT. Gjithashtu, kemi vazhduar të identifikojmë dhe vlerësojmë çdo rrezik të mundshëm për të përmirësuar më tej mjetet apo kontrollet periodike të cilat synojnë ti vijnë në ndihmë punonjësve tanë me qëllim parandalimin e ekspozimit te tyre të drejtpërdrejtë ndaj një rreziku të tillë dhe për të garantuar stabilitetin e bankave dhe integritetin e tyre personal.

Rreziqet rregullatore

KODI I ETIKËS DHE ABC

Kodi ynë i Etikës përmbledh vlerat, besimet, parimet e bankës sonë dhe grupit OTP dhe është baza dhe udhëzimi i operacioneve etike të biznesit.
Gjatë vitit 2023, zhvillimet në etikë u shtrinë në kuadrin rregullator duke transpozuar rregulloret e grupit në lidhje me Sinjalizimin, Kodin e Etikës dhe Politikën e Dhuratave dhe Eventeve në mjedisin lokal

Kodi i Etikës së OBA gjëndet në faqen zyrtare të Bankës OTP Albania:
https://otpbank.al/en/about-us/engagements/code-of-ethics/

KONFLIKTI I INTERESIT

Situatat e konfliktit të interesit mund të jenë të pranishme në të gjitha aktivitetet e biznesit dhe mund të lindin midis Bankës dhe klientëve të saj, punonjësve të Bankës dhe klientëve apo Bankës dhe punonjësve, në transaksione përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta personale. Dështimi në njohjen dhe administrimi në mënyrën e duhur të konflikteve të interesit mund të rezultojë në pasoja të papërshtatshme ose të pafavorshme për klientët, Bankën dhe punonjësit.
Gjatë 2023, OBA finalizoi dhe publikoi rregulloren e rishikuar të Konfliktit të Interesit, në të njëjtën linjë me rregulloren e Grupit. Të gjithë punonjësit tanë janë trajnuar se si të dallojnë nëse janë pjesë e ndonjë situate konflikti interesi dhe u kërkohet ta raportojnë atë sa më shpejt të jetë e mundur.

MBROJTJA E KLIENTIT

Funksioni i përputhshmërisë ne OTP Bank Albania sha, edhe gjatë vitit 2023, ka vlerësuar të gjitha ankesat e klientëve dhe ka siguruar menaxhimin e çdo rreziku të mundshëm përputhshmërie lidhur me to, me qëllim që të përmbushë detyrimet e mbrojtjes së klientit dhe ka ndjekur nga afër kërkesat e përditësuara rregullatore lokale në lidhje me standardet e transparencës në operacionet, produktet dhe shërbimet e Bankës duke përmbushur kërkesat e klientëve në këtë drejtim. Mbrojtja e klientëve ka qenë gjithashtu në fokus të projektit të bashkimit të të dy bankave.

MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË TAKSAVE

Në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare të taksave, OBA arriti të raportojë në mënyrë të suksesshme tek IRS raportin vjetor për FATCA, gjithashtu edhe tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shqipëri, mbi Standartet e përbashkëta të Raportimit (CRS) duke reflektuar ndryshimet që pësoi nga bashkimi me Alpha Bank dhe mënyrën e funksionimit të saj.

RISKU REPUTACIONAL

Është përgjegjësi e të gjithë punonjësve të Bankës që të jenë në përputhje me rregullat tona të brendshme dhe të veprojnë me integritet në mënyrë që të mos e ekspozojnë Bankën ndaj ndonjë rreziku të mundshëm të reputacionit.
Me qëllim menaxhimin e mëtejshëm të këtij rreziku, në ato proçese të cilat mund të jenë të ekspozuar më tepër ndaj tij, jane dizenjuar dhe ekzekutuar kontrolle të strukturuara si për shëmbull mbi prokurimet, sponsorizimet dhe marrëdhëniet kontraktuale, etj.

TRAJNIM DHE NDËRGJEGJËSIM

Për tu siguruar që punonjësit të kenë njohuritë dhe aftësinë e duhura teknike, dhe t'i mbajë ata të informuar mbi ndryshimet dinamike që karakterizojnë veprimtarinë e përputhshmërisë,

Banka ka krijuar një program i cili përfshin trajnimet periodike në vend, trajnimet prezantuese fillestare për të gjithë punonjësit e rinj dhe seanca të dedikuara apo metoda të tjera trajnimi të cilat kanë për qëllim të rrisin ndërgjegjësimin ndaj çështjeve të përputhshmërisë.

Angazhimet e OTP Bank sa i takon aktivitetit të përputhshmërisë si:

- Kodi i Etikes;
- Sinjalizimi;
- Politika e Përputhshmërisë;
- Politika e Sanksioneve;
- Financimi i Industrisë së Mbrojtjes;
- Sanksionet Efektive ndaj Rusisë;
- Përputhshmëria rregullatore;

...janë të publikuara në faqen e saj zyrtare dhe të aksesueshme nga palët e interesuara.

Rezultatet financiare

Rezultatet Financiare 2023

E ARDHURA BANKARE NETO
€92.59mln
+24%
% RRITJE vs 2022

E ARDHURA NETO
€44mln
+39%
% RRITJE vs 2022

KTHIMI NGA KAPITALI
23.52%
+6.12%
% RRITJE vs 2022

RAPORTI SHPENZIME / TË ARDHURA
44.74%
-10.95%
% RRITJE vs 2022

Performanca e Kredive dhe Depozitave

KREDITË OUTSTANDING
€932*mln
-0.15%
RRITJE vs 2022

GJENDJA E DEPOZITAVE
€1363.82*mln
+5.7%
RRITJE vs 2022

PJESA E TREGUT TË KREDIVE
€1363.82*mln
-1.2%
RRITJE vs 2022

Shënim: Treguesit e performancës monitorohen duke përjashtuar kostot e integrimit nga rezultati financiar dhe duke marrë në konsiderate FX impaktin në outstanding të kredive dhe depozitave.

Bankingu i Segmenteve

BANKINGU I KORPORATAVE

Gjatë vitit 2023, Banka OTP Albania përmirësoi ndjeshëm performancën financiare, përmbushi qëllimin për të rritur përfitueshmërinë dhe njëkohësisht duke ruajtur efektivitetin operacional, ku rol kryesor në arritjet e rezultateve financiare ka pasur indeksimi i normave të interesit tek produktet bankare, i cili ka qenë më i shpejtë për kreditë dhe letrat me vlerë. Ndërkohë për llogaritë dhe depozitat ka qenë me ritme më të ngadalta. Në fakt, kjo tendencë është vërejtur në aktivitetin bankar, në të gjithë rajonin dhe më gjerë.

Divizioni i Bankingut të Korporatave e mbylli vitin me performancë shumë të mirë, veçanërisht në aspektin në përfitueshmërinë e portofolit, njëkohësisht duke vazhduar të mbështesë aktivitetin e kompanive të mëdha dhe kontribuar pozitivisht në ekonominë e vendit. Ndër arritjet kryesore veçohen si më poshtë:

• Portofoli i kredisë për Korporatat e mëdha dhe SME, mbulon 14% të pjesës së tregut duke e pozicionuar Bankën OTP Albania si një kontribues të fuqishëm në tregun bankar. Divizioni i Korporatave ka luajtur një rol të rëndësishëm në rezultatin financiar të bankës, pasi shumica e ekspozimeve janë të kontraktuara me spread të favorshëm.

• Gjithashtu, Banka ka shfaqur ritme të qëndrueshme rritjeje në volumin e depozitave të korporatave të klientëve të këtij segmenti të cilët u rritën me 13%[1] nga viti 2023, krahasuar me vitin 2022 (duke përfshirë edhe efektin e kursit të këmbimit). Banka OTP Albania ka përfituar nga njohja e brandit së saj duke siguruar flukse hyrëse të konsiderueshme, prej fondeve të klientëve.

Divizioni i Bankingut të Korporatave vazhdon t'u ofrojë klientëve, produkte dhe shërbime të jashtëzakonshme, përmes rrjetit të gjerë të degëve, platformave digjitale dhe Departamentit të Transaksioneve Globale Bankare duke siguruar zgjidhje të përshtatshme në përputhje me nevojat e ndryshme të klientëve. Për më tepër, ofrohet një gamë e gjerë e produkteve dhe shërbimeve financiare, të përshtatura me kërkesat specifike të subjekteve si: organet qeveritare, kompanitë e mëdha, të cilat ofrohen dhe nëpërmjet Divizionit të Korporatave nga bankat e tjera.

Divizioni i Korporatave ka përmbushur në mënyrë befasuese treguesit kryesorë të performancës të vendosur nga industria bankare dhe ka forcuar pozicionin si bankë kryesore, në matjet më të rëndësishme për segmentet e SME-ve, të korporatave të mëdha dhe klientëve ndërkombëtarë, që divizioni u shërben.

AKTIVITETI I KREDIVE:

• Portofoli i Linjave të Kreditit në Bilanc, nga aktiviteti i kredidhënies, Divizioni i Bankingut të Korporatave realizoi përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 2023, duke disbursuar në total vlerën prej 138 milionë euro, e cila përfaqëson një rritje të dukshme prej 42%, krahasuar me rezultatet e vitit 2022. Për t'u theksuar, Segmenti i Korporatave në Bankën OTP Albania (SME & Korporatat e mëdha) vazhdojnë të mbajnë vendin e katërt si pjesë të tregu. Disbursimet e reja nga Divizioni i Korporatave kanë ndikuar në rritjen e përfitueshmërisë së Bankës, pasi pjesa më e madhe e ekspozimeve janë kontraktuar me spread të favorshme.

• Portofoli i Linjave të Kreditit jashtë Bilancit, (kryesisht linjat e kreditit në Financa Tregtare, Garanci Bankare dhe Letër Kredi) kanë qenë vazhdimisht në përputhje me nevojat e klientëve, duke ruajtuar pjesën tonë të tregut. Për disa vite, Banka OTP Albania është një nga banka kryesore në vend për ofrimin e produkteve të Financave Tregtare për sa i përket volumit, cilësisë së klientëve dhe marrëveshjeve të realizuara.

• Portofoli i Leasing Financiar, ka përforcuar pozicionin e saj edhe në treg; aktualisht renditet e treta për nga madhësia e portofolit.

• E rëndësishme, cilësia e portofolit tonë, siç tregohet dhe nga raporti i NPL-ve, ka qenë në monitorim dhe e qëndrueshme.

• Banka OTP Albania ofron një gamë të gjerë produktesh kredie, në përputhje me standardet kombëtare dhe praktikat më të mira në treg. Këtu përfshihen, investimet në asete fikse me financim të strukturuar, kredi me afat, LC/LG, etj.; financimin e kapitalit qarkullues që mbulon tërë ciklin e biznesit si linja LG/LC, overdraft, parapagim mbi faturat, linjë kreditimi vetë-likuiduese, linja me limit të shumë qëllimshme,

1 - Rritja e depozitave të korporatave është shprehur nga Korporatat duke përfshirë efektin kursit të këmbimit që do të thotë krahasimi i volumeve të dy viteve, nuk është bërë mbi outstanding në Lek, por i axhustuar për efekte kursi, sepse sipas biznesit nuk tregon rritjen reale.

• Karakteristikat e produkteve të kredisë janë të përshtatura për çdo segment të klientëve duke marrë parasysh profilin e riskut, llojet e kolateralit, dhe volatilitetin e biznesit.

• Në nivel produkti, janë zhvilluar oferta të ndryshme bazuar në segmentet e klientëve duke konsideruar me kujdes nevojat dhe karakteristikat e biznesit. Këto oferta përfshijnë kredi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, si dhe kredi me çmime konkurruese, të përshtatura për sektorë të veçantë të biznesit.

• Banka OTP Albania vazhdon bashkëpunimin e saj me BERZH-in ("SME Competitiveness Program, Risk Sharing, Agro & Hotels Financing") dhe RCGF (Rural Credit Guarantee Foundation) me qëllim thjeshtimin e procesit të huadhënies për tregun rural si dhe për segmentin e bizneseve që nuk plotësojnë kërkesat e sektorit bankave. Ky bashkëpunim është një alternativë e favorshme për klientët, pasi banka ofron mundësinë e këshillimit duke mundësuar financimin e kredisë për bizneset më pak të sigurt, nëpërmjet programeve që ofrojnë ndarjen e riskut mes organizatave ndërkombëtare (BERZH) dhe programeve incentivuese (rimbursim të fondeve mbi investimin).

• Ruajtja e niveleve të ulëta të kredive me probleme (NPL), shoqëruar me financime të vetë-mjaftueshme (pavarur) ka mundësuar ofrimin e çmimeve konkurruese në kredidhënie, duke ruajtur përfitime të kënaqshme.

Qëllimet strategjike të realizuara në një hark të shkurtër kohor, të cilat kanë forcuar qëndrueshmërinë:

• Financiare, Banka OTP Albania ka pasur si objektiv të mbajë një raport minimal kosto-të ardhura, si dhe është fokusuar në ruajtjen e një strukture të të ardhurave neto që është më pak e ndjeshme ndaj luhatjeve të normave të interesit dhe kostove të riskut.

• Digjitalizimin dhe teknologjinë, duke aplikuar një infrastrukturë teknologjike që është shumë e sigurt për të ardhmen, dhe të shkëlqyer në sigurimin e të dhënave, nëpërmjet të cilës është e mundur të ofrohen shërbime digjitale inovative.

• Organizative, kemi zbatuar me shpejtësi praktikat më të mira dhe kemi investuar në tërheqjen, zhvillimin dhe mbajtjen e punonjësve më të mirë.

TRANSAKSIONET BANKARE DHE BAZA E KLIENTËVE:

Përveç kredive, Banka OTP Albania ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare për një numër të konsiderueshëm klientësh të korporatave. Vetëm gjatë vitit 2023, klientët e korporatave kanë kryer mbi 3.4 miliardë euro transferta bankare përmes Bankës OTP Albania, krahas shërbimeve të tjera bankare. Krahasuar me statistikat e fundvitit 2022, është realizuar një rritje prej 3% nga segmenti i korporatave në flukset hyrëse. Divizioni i Korporatave dhe SME-ve numëron rreth 20,000 klientë pagamarrës, të cilët vijnë prej kompanive të cilëve menaxhohen prej tyre.

E fundit, por shumë e rëndësishme, gjatë vitit 2023 Banka realizoi me sukses bashkimin teknik të sistemit qëndror të Bankës.

Bankingu Retail

KANALI I SHITJES DEGË DHE JO-DEGË

Viti 2023 ishte një vit i rëndësishëm pasi rrjeti i degëve të OTP pësoi një transformim thelbësor, rrjedhojë e finalizimit të projektit të bashkimit. Një arritje e rëndësishme gjatë vitit ishte zgjerimi i hartës gjeografike të degëve duke pasur më shumë zona mbulimi me degë të reja dhe optimizim të rrjetit në zonat urbane, duke qëndruar në një numër total 49 degë (30% më shumë se një vit më parë).

Harmonizimi i degëve përfundoi në një periudhë të shkurtër kohore duke qenë se rreth 90% e degëve u bashkuan gjatë tremujorit të parë të vitit duke siguruar një shërbim të mirë, të besueshëm dhe të thjeshtë me qëllimin kryesor, ruajtjen e përvojës së jashtëzakonshme të klientit.

Rrjeti i degëve kaloi në një proces reformimi total në drejtim të optimizimit të shërbimit ndaj klientit, rikonstruksioneve të plota apo edhe degëve në vendndodhje krejt të reja që janë më të lehta për t'u arritur nga klientët. Aktualisht jemi banka e katërt me rrjetin më të madh të degëve me një shpërndarje të gjerë gjeografike, duke na renditur të dytin në këtë aspekt në treg. Ky është vërtetimi i strategjisë sonë afatgjatë për zbatimin e një modeli dege që synon transformimin dhe përmirësimin cilësor të shërbimit ndaj klientit, krijimin e një eksperience ekskluzive bankare me theks në rritjen e aktivitetit të biznesit dhe eficiencën e rrjetit të degëve të bankës.

Faza tjetër e strategjisë sonë në drejtim të optimizimit të degëve do të vazhdojë të jetë edhe më e pranishme në zonat ku ka ende mundësi për të shtuar biznes në përputhje me përqendrimin e popullsisë dhe ndërmarrjeve. Duke pasur parasysh mbulimin tonë të zgjeruar të rrjetit dhe progresin e konsiderueshëm të bërë vitin e kaluar, ne besojmë se jemi në gjendje të konkurrojmë dhe të fitojmë në këtë mjedis duke zhvilluar avantazhe shtesë konkurruese. Angazhimi ynë do të vazhdojë të jetë përmirësimi i prezencës tonë fizike nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të degëve. Në të ardhmen, ne do vazhdojmë të shfrytëzojmë fuqinë e rrjetit tonë për të krijuar vlerë të shtuar për partnerët dhe klientët.

Përveç kanalit të degës, gjatë vitit 2023 Banka vendosi një kanal shtesë të shitjeve fizike (jo-degë), Bank@Work, duke zgjeruar gamën e kanaleve alternative të shitjeve me synim nxitjen e gjenerimit të biznesit. Nëpërmjet zbatimit të këtij kanali pritet një ndikim pozitiv në aktivitetin e kreditimit dhe të shitjeve të kryqëzuara duke rritur përfitueshmërinë edhe nga kanalet alternative, jo-degë. Ekipi i përkushtuar në këtë drejtim, siguron përpjekje të përqendruara në identifikimin e mundësive dhe koordinimin e aktiviteteve të programit duke promovuar dhe shitur produkte për individë drejtpërdrejt tek punonjësit në vend, në mënyrë që Banka të jetë më afër klientëve në vendin e tyre të punës. Duke ofruar shërbime financiare të personalizuara dhe përfitime me vlerë të shtuar, kanali Bank@Work ka forcuar besnikërinë dhe mbajtjen e klientëve. Shfrytëzimi i këtij kanali gjithëpërfshirës do të rrisë mundësitë për një bashkëpunim efektiv sinergjik midis klientëve të bankës dhe biznesit.

DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT PËR INDIVIDË

Viti 2023 ka qenë një vit me sfida të rëndësishme duke filluar me finalizimin e bashkimit ligjor të 2 bankave dhe kulmuar me transformimin total, atë të bashkimit teknik. Gjatë gjithë vitit ka pasur zhvillime në drejtim të ofrimit të një numri të madh produktesh dhe shërbimesh për klientët e bankës, produkte të cilat janë bërë gjithnjë e më të rendesishëm dhe të përdorura nga klientët tanë.

Në një treg tashmë tepër dinamik të udhëhequr nga zhvillimet teknologjike, rrjedhimisht edhe automatizimi i proceseve dhe shërbimeve ka qenë në fokus parësor për Bankën OTP Albania. Përveç kredisë hipotekore, tashmë të gjithë produktet e kredive konsumatore për Individë procesohen në mënyrë automatike përmes Sistemit të Origjimit të Kredisë, duke lehtësuar në këtë mënyrë ngarkesën operacionale në Degë, si dhe duke ndikuar pozitivisht në përvojën dhe kënaqësinë e klientit.

Gjithashtu, në Sistemin e Origjimit të Kredisë janë kryer automatizime shtesë të cilat bëjnë të mundur ndërlidhjen me sistemin bazë të Bankës për disbursimin automatik të kredisë, duke minimizuar kështu inputin manual dhe rritur efikasitetin.

Produktet e përditshme bankare, si dhe ato të investimeve janë promovuar vazhdimisht përmes ofertave preferenciale, duke bërë të mundur dhe lehtësuar udhëtimin e klientëve përmes paketave tona të dedikuara të produkteve. Janë zhvilluar edhe fushata depozitash me oferta preferenciale për depozituesit tanë, duke kombinuar të dy faktorët: normat e interesit me karakteristikat tërheqëse të produktit.

Aktiviteti i sigurimeve bankare ka kaluar nje fazë transformimi, ku banka ka shtruar rrugën për të kaluar nga licenca e Agjentit ne Sigurime, në atë të Brokerit duke synuar kështu zgjerimin e aktivitetit me ndikim pozitiv për klientët e Bankës.

BANKINGU DIGJITAL

Në një treg financiar i cili evoluon me shpejtësi, Banka OTP Albania ka një qëllim të thjeshtë: të ofrojë për klientët e saj një përvojë sa më të qetë dhe të lehtë në të gjithë kanalet digjitale.
Platforma Digjitale është si një mik i besueshëm i cili ndihmon klientët në udhëtimin e tyre financiar në Bankën OTP Albania.

Me përdorimin e kësaj platforme klientët kanë pamshmëri të plotë mbi të gjithë transaksionet, ata gjithashtu mund të menaxhojnë llogaritë e tyre me lehtësi dhe mbi të gjitha kanë siguri që të dhënat e tyre janë plotësisht të mbrojtura.

Në vitin e kaluar, kjo platformë ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e përvojës së klientëve duke rritur aksesin dhe përdorimin më efikas dhe më përfshirës të saj.

Gjatë vitit 2023, platforma Electronic Banking e Bankës OTP Albania, u përditësua me funksione të reja të cilat përmirësojnë dhe thjeshtojnë ndjeshëm përvojën e klientëve tanë në aplikacion duke i bërë ata disa herë më të pavarur në menaxhimin e parave dhe produkteve, si psh:

- Përditësimi në kohë reale i balancës së llogarisë dhe pagesave;
- Riaktivizimi i platformës dhe zhbllokimi i kodit PIN, direkt përmes platformës;
- Aftësia për të paguar faturat fiskale në grup;
- Përmirësimi i procesit të pagesës së kartës së kreditit;
- Shkarkimi i SWIFT nga aplikacioni celular;
- Pagesa me kod QR,
- Shërbimi i rimbushjes së telefonit.

Banka OTP Albania duke patur gjithashtu në fokus mjedisin, është përkushtuar për reduktimin e gjurmëve të karbonit duke orientuar klientët drejt kanaleve digjitale. Angazhimi ynë është të qëndrojmë pararojë, duke e bërë bankën digjitale më të mirë për klientët dhe për planetin tonë.

Platforma jonë digjitale, vijoji trendin rritës për sa i përket përdorimit të saj. Kjo platformë ka treguar rritje të vazhdueshme në drejtim të penetrimit të bazës së klientëve aktivë, duke u reflektuar me një rritje prej 71%, krahasuar me vitin e kaluar, në numrin e transkaksioneve të kanalizuar nëpërmjet kësaj platforme.

RRJETI I ATM-VE

Banka ka zgjeruar rrjetin e ATM-ve duke qenë e pranishme në vend me 200 ATM duke u renditur e para në treg, ndërsa punon për përmirësimin me funksionalitete shtesë.
Gjithashtu, Banka OTP Albania ka shtrirë praninë e saj në treg me ATM të cilat disponojnë funksionalitetin Cash In. Si rezultat i procesit të bashkimit, si dhe zgjerimit të flotës së partneritetit, rrjeti i ATM-ve të Bankës OTP Albania dominon tashmë në territorin shqiptar.

Fokusi ynë ka qenë përdorimi i ATM-ve për Cash out, për të kontrolluar shumën e parave të disponueshme, por kryesisht për Cash-In. Të gjitha veprimet e përmendura rezultojnë me rritje progresive.

KARTAT

Bank OTP Albania ofron produkte të ndryshme kartash për të përmbushur kërkesat e klientëve, duke qenë një nga konkurrentët kryesorë në treg.
Portofoli i kartave ka shënuar rritje pozitive për sa i përket numrit të kartave dhe transaksioneve të kryera në të gjithë kanalet alternative (ATM, POS dhe E-commerce).

Kartat e Bankës tonë ofrojnë teknologjinë më të fundit, përdorimin e tyre pa kontakt dhe 3DSecure. Nga totali, afërsisht 70% e kartave të debitit dhe kreditit janë karta aktive, që do të thotë se kryejnë transaksione në baza të rregullta duke qenë në përputhje me strategjinë e Bankës dhe fokusimin e klientëve drejt kanaleve digjitale.

Gjatë vitit të kaluar Banka ka lançuar fushata të ndryshme duke rimbursuar klientët e rinj dhe ekzistues për përdorimin e kartës. Fokusi kryesor i Bankës sonë është fillimisht edukimi i klientëve duke i drejtuar ata drejt kanaleve digjitale, për shërbim, komoditet dhe përfitime më të mira.

RRJETI POS

Gjatë vitit 2023, Banka OTP Albania ka prezantuar në treg dhe tek klientët e saj (tregtarët) teknologjinë më inovative dhe më të fundit në pajisjet POS.

Fokusi i Bankës ka qenë:
1. Ofrimi i teknologjisë më të mirë në treg;
2. Standardet më të larta të shërbimeve dhe marrëdhënieve tregtare;

Duke qenë ekskluzive dhe duke ofruar tre skema pagesash: AMERICAN EXPRESS, VISA dhe MASTERCARD.

DEPARTAMENTI MSE

Në vitin 2023, Banka OTP Albania ka demonstruar fleksibilitet të pashembullt në sektorin e saj të MSE-ve, duke u pozicionuar si bankë lider në ofrimin e zgjidhjeve të përshtatura të kreditimit.

Angazhimi i bankës për të kuptuar nevojat unike të MSE-ve ka lejuar një mjedis financiar dinamik dhe mbështetës, gjithmonë duke nxitur rritjen dhe qëndrueshmërinë.
Veçanërisht, Banka OTP Albania është angazhuar në mënyrë aktive në partneritete për ndarjen e rrezikut me entitete si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe ADGF, duke përforcuar angazhimin e saj ndaj praktikave financiare të përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

Duke parë përpara për vitin 2024, Banka OTP Albania është gati të prezantojë produkte financiare inovative të dizenjuara për t'iu përshtatur peizazhit gjithnjë në ndryshim të sektorit të MSE-ve.
Kjo qasje, pasqyron më së miri përkushtimin e Bankës për të qëndruar në pararojë me tendencat e tregut dhe për të siguruar që Banka OTP albania të jetë gjithmonë partner i besueshëm për bizneset, të cilët operojnë në kushtet sfiduese të botës moderne të biznesit.

Me një themel të fortë të ndërtuar mbi fleksibilitet, nismën për ndarjen e rrezikut dhe një përkushtim ndaj inovacionit, Banka OTP Albania vazhdon të jetë një lojtar kyç në mbështetjen e rritjes dhe suksesit të bizneseve MSE.



Tregjet Globale

Viti 2023 ishte një vit i suksesshëm persa i përket aktivitetit të Tregjeve Globale në tërësi. Shkrirja e realizuar në dhjetor të vitit 2022 i dha edhe aktivitetit të Tregjeve një hov të ri, si në aspektin e biznesit ashtu edhe në aspektin e rritjes së personelit dhe mundësisë për të akomoduar dhe ofruar cilësi shërbimi një klientele në rritje. Kjo mundësi u shfrytëzua me profesionalizëm duke sjellë përmirësim të ndjeshëm në tre indikatore: volume, fitim dhe numër transaksionesh.

Në lidhje me aktivitetin e investimeve në tituj, viti 2023 ishte vit zgjerimi dhe njëkohësisht konsolidimi. Zgjerimi ka qenë kryefjala që do të përkufizonte rritjen e portofolit të klientëve, rritjen e aksesit në tregje ndërkombëtare, shoqëruar kjo edhe me një punë të vazhdueshme të bërë përgjatë gjithë vitit me qëllim heqjen e kufizimeve ligjore dhe rregullative që do të mundësojë edhe zgjerimin e tipologjisë së titujve të ofruar në të ardhmen e afërt. Nga ana tjetër, konsolidimi i prezencës në treg është shoqëruar me standardizimin e procedurave, proceseve dhe unifikimin e trajtimit të klientëve, kryesisht kjo për bazën e klientëve të trashëguar nga procesi i bashkimit të bankave.

Për sa i përket prezencës në tregun lokal, është vijuar me akomodimin e klientëve të trashëguar nga bashkimi i bankave dhe kalimin e tyre nën një kuadër ligjor të unifikuar duke nënshkruar kontratën: "Për Shërbimet e Investimeve në Tregjet Globale", dizenjuar sipas kuadrit rregullativ të kërkuar nga Autoriteti, e cila garanton transparencë dhe mbrojtje të interesit të klientit.

Në tregun e brendshëm, rritja e yield-eve ka shoqëruar një kërkesë të qëndrueshme dhe në rritje për pjesëmarrje në ankandet e tregut primar, kryesisht nga individët. Për shërbimin e ndërmjetësimit në tregun e brendshëm, eksperienca tashmë e akumuluar nga stafi i Bankës ka mundësuar që qëllimi kryesor të jetë rritja e eficiencës dhe rritja e kënaqësisë së klientit.

Njohja më e mirë me investimet e huaja, shoqëruar me yield-et në rritje për pjesën më të madhe të vitit, është përkthyer në një kërkesë të rritur për investime të huaja. Shoqërimi i kësaj kërkese dhe adresimi në tregje ndërkombëtare ka qenë në fokus të Tregjeve Globale. Gjatë vitit 2023, Banka OTP Albania ka rishikuar versionin e integruar të Politikës së Ekzekutimit të Urdhërit të Klientit, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Lidhur me shërbimet e kujdestarisë, klientët kanë pasur mundësi të marrin informacion të personalizuar dhe në kohë reale. Kjo u ka mundësuar pjesëmarrje në operacione specifike të ndërmarra nga emetues apo kompani, duke rritur ndjeshëm nivelin e shërbimit të ofruar në investimet në tituj. Ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit në ankand e titujve të Qeverisë është integruar me zgjerim të aksesit në tregjet ndërkombëtare. Gjatë vitit 2023 janë hedhur bazat për vendosje të marrëdhënies institucionale me brokers ndërkombëtar të tjerë, ndërkohë që është punuar paralelisht edhe për draftin e kuadrit rregullativ dhe operacional për zgjerimin e tipologjisë së titujve që do të mund të ofrohen në vijim.

Aktiviteti i këmbimit valutor në vitin 2023 ka shënuar një rekord në volume dhe fitime. Klientët e rinj, duke përfshirë këtu edhe klientë të trashëguar nga Alpha Bank, u pajisën me kontratë që mundëson komunikimin direkt me Tregjet Globale dhe realizimin e transaksioneve në mënyrë automatike. Përpos rritjes së klientelës, një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në shtimin e volumeve, ka qenë vlerësimi i ndjeshëm i monedhës vendase, kundrejt monedhës Euro. Ky çift monedhash mbulon pjesën më të madhe të transaksioneve që lidhen me tregtinë e jashtëme dhe pasurinë e patundur. Mbivlerësimi i Lekut kundrejt Euros, në kombinim me diferencën e vogël të interesave të këtyre dy monedhave, nxiti konvertimin e nje sasie te konsiderueshme kredish, nga Euro ne Lek.

Luhatjet e kursit të këmbimit gjatë pjesës më të madhe të vitit, kanë sjellë marzhe të zgjeruara të tregut. Tregjet Globale janë kujdesur që të ofrojnë çmime shumë kompetitive, ndaj klientëve. Forca shitëse ka një njohje të mirë të klientëve, duke pasur një komunikim proaktiv me ta, në mënyrë që të njihet në kohë me nevojat e tyre për këmbime valutore. Kjo ka ndihmuar edhe në trajtimin e transaksioneve të mëdha, duke shmangur maksimalisht surpriza të papriturat në treg.

Në lidhje me aktivitetin e letrave me vlerë, rritja vjetore neto për 2023 rezulton në 7% me një portofol në vlerë nominale 37.8 B ALL .OTP Bank Albania ka rritur portofolin e letrave me vlerë me kosto të amortizuar në vitin 2023 me 7.3 B ALL, kryesisht këto investime të reja kanë qëne në obligacione me Qeverinë Shqiptare.
Të ardhurat nga interesi që gjeneron portofoli i letrave me vlerë zë një peshë prej 20% në totalin e të ardhurave nga interesi. Rritja në të ardhura nga interesi gjatë vitit 2023 rezulton në 10% krahasuar me një vit më parë.

Menaxhimi i Riskut
në OTP Bank Albania SH.A.



OTP Bank Albania ka ndërtuar dhe konsoliduar kulturën e saj të menaxhimit të rrezikut, në perputhje me përditësimin e rregulloreve.

Rreziku menaxhohet përmes:

- Organizimit specifik dhe sistemeve;
- Kuadrit të orëksit për rrezik dhe treguesëve të oreksit për rrezik ;
- Procedurave që përfshijnë standardet më të larta të rrezikut të zbatuara në të gjithë organizatën;
- Limiteve lokalë të vendosur;
- Një gamë të gjerë kontrollesh.

Monitorimi rregullator dhe monitorimi operacional sigurohen nëpërmjet:

- Raportimit të dedikuar me përputhshmërinë më të lartë me standardet e Bankës së Shqipërisë dhe SNRF.
- Treguesëve sasiorë dhe cilësorë në standardet lokale dhe të Grupit në baza të rregullta dhe të detyrueshme.

OTP Bank Albania respekton në çdo kohë rregullat dhe kufizimet e detyrueshme nga kuadri ligjor dhe rregullator i Bankës së Shqipërisë si dhe çdo kufizim të parashikuar nga Grupi OTP (dhe rregullat normative të Grupit) ose ofruesit e tjerë të fondeve.
Kjo kulturë e fortë dhe përditësimi i vazhdueshëm lejon mbështetjen e zhvillimit të portofolit tonë të kredisë nën kontroll të rreptë të rreziqeve tona, duke rezultuar në një portofol kredie me cilësi të lartë.

TË GJITHË LLOJET E RISQEVE MBULOHEN PËRMES QEVERISJES SË DEDIKUAR

01 STRUKTURA ORGANIZATIVE E DIVIZIONIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT ËSHTË PËRSHTATUR PËR TË MBËSHTETUR MË MIRË ZHVILLIMIN E OBA-S


Divizioni i Riskut ndjek strukturën e Grupit OTP dhe është përshtatur për të identifikuar, parandaluar dhe menaxhuar më mirë rreziqet e mundshme që mund të ndikojnë në financat dhe operacionet e përgjithshme të Bankës. Çdo funksion brenda riskut është përgjegjës për zbatimin e kornizave të politikave, procedurave dhe kontrolleve, të cilat kërkojnë planifikim të kujdesshëm, rishikime të rregullta dhe përditësime mbi rreziqet e portofolit dhe monitorim për t'i shërbyer më mirë kërkesave në rritje të klientëve.

02 PARIMET E RREZIKUT TË KREDISË JANË PËRFORCUAR PËR TË TRAJTUAR ZHVILLIMIN SI NË SHITJEN ME PAKICË ASHTU EDHE ATË KORPORATË


Politikat e administrimit të rrezikut të OBA-s, janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar të gjitha llojet e rreziqeve, për të vendosur kufijtë dhe kontrollet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve me anë të sistemeve administrative dhe informacioni të besueshme dhe të përditësuara.

OBA rishikon rregullisht politikat dhe procedurat e saj të menaxhimit të rrezikut, duke synuar gjithmonë praktikat më të mira dhe përputhjen me normativën e Grupit Bankar. Përgjegjësia individuale dhe profesionalizmi i ndërtuar dhe forcuar vazhdimisht përmes trajnimeve, është thelbësor për të krijuar një kulturë dhe mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv.

Oreksi ndaj rrezikut dhe politikat e huadhënies përcaktohen dhe rishikohen rregullisht me anëtarët e Bordit dhe Komitetit Ekzekutiv: sektorët e synuar, industritë, klientët, segmentet, llojet e produkteve, garancitë dhe risqet e zbutura.




PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË KREDISË DHJETOR 2022




PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË KREDISË DHJETOR 2023

Rritja e portofolit të kredisë ka qenë në nivele të kënaqshme për vitin 2023, ndërkohë që raporti i NPL-ve është në të njëjtën vlerë në 7.44%, një nga më të ulëtit në sistemin bankar shqiptar, për shkak të standardeve të larta të kreditimit dhe monitorimit të fortë të ekspozimeve.



PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË KREDISË DHJETOR 2022



PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË KREDISË DHJETOR 2023

Provigjionimi, si faktor kyç në rezultatin final financiar të bankës, është nën përgjegjësinë e Divizionit të Menaxhimit të Riskut, si për rregullat lokale ashtu edhe në rregullat e SNRF-ve.

Nuk vihet re asnjë ndryshim i rëndësishëm në mbulimin e provigjioneve vit pas viti, vetëm disa ndryshime të vogla për shkak të rregullimeve të PD-së vjetore dhe faktorëve makroekonomikë. Ndërkohë, mbulimi me provigjion për kreditë me probleme ka arritur në një nivel prej 61.72% në portofolin e NPL-ve, për shkak të vlerësimit individual për klientët e klasifikuar ne Stage 3. Ky nivel mbulimi ka siguruar një menaxhim të mirë dhe të sigurt të portofoleve të bankës.

Për fshirjen e kredive me probleme janë marrë masa siç rekomandohet prej Rregullatorit si në segmentin retail (shitje me pakicë) ashtu edhe atë korporativ.

03 RISQET E TREGUT

Risku i tregut menaxhohet dhe monitorohet nga Sektori i Menaxhimit të Risqeve të Integruara, pjesë e Divizionit të Manaxhimit të Riskut. Monitorimi i riskut të tregut konsiston në monitorimin e limiteve të pozicioneve të hapura të tregut dhe limitet e kundërpartive të aprovuara nga Bordi Drejtues, të cilat menaxhohen si në nivel lokal ashtu edhe për Grupin në baza ditore. Qëllimi është përfitimi nga variacionet e pritshme në kurset e këmbimit të valutave.
Respektimi i të gjitha limiteve bëhet me metodën më konservatore të mundshme.

Monitorimi i përditshëm përfshin:
- Rrezikun e kundërpartisë;
- Rrezikun e pagesës;
- Rrezikun e zëvendësimit;

Monitorimi i përmuajshëm përfshin:
- Rrezikun e qeverisë;
- Rrezikun e shtetit;
- Rrezikun e kundërpartisë;

04 RISQET OPERACIONALE DREJTOHEN NGA NJË NJËSI E POSAÇME NËMËNYRË QË TË MBULOHEN TË GJITHË ASPEKTET E BANKËS

Menaxhimi i Riskut Operacional kryhet nga Sektori i Menaxhimit të Riskut të Ndërmarrjeve, pjesë e Divizionit të Riskut që nga viti 2019. Objektivi i tij është të ofrojë një kuadër të përgjithshëm që përfshin aktivitetin e identifikimit, monitorimit dhe kontrollit të rreziqeve që lidhen me njerëzit, sistemet, proceset apo ngjarjet e jashtme dhe të ndjekë e të hartojë planet e veprimit për të zbutur rreziqet e mundshme që banka mund të përballojë gjatë veprimtarisë së saj.

05 RISQET E LIKUIDITETIT ADMINISTROHEN NË DIVIZIONIN E RISKUT PËRMES FUNKSIONIT TË SEKTORIT TË MENAXHIMIT TË RISQEVE TË INTEGRUARA

Megjithatë, në fushën e veprimtarisë së saj të administrimit të likuiditetit, Banka OTP Albania bashkëpunon me disa banka jorezidente dhe rezidente (këtu përfshihen vetëm disa prej bankave më të mira evropiane dhe disa banka të njohura shqiptare), të cilat i nënshtrohen vlerësimit periodik të rrezikut të kundërpartisë dhe kufizimeve nga departamentet e specializuara në Drejtorinë Qendrore (Banka Mëmë). Në nivel lokal, Departamenti i Tregjeve Globale dhe Divizioni i Menaxhimit të Riskut në Bankën OTP Albania janë përgjegjës për monitorimin e përputhjes së plotë me limitet e miratuara të palëve – në bashkëpunimin me funksionin e ALM pranë Divizionit të Financës.

06 RISQET STRUKTURORE

Risku Strukturor përfshin rreziqet e normës së interesit dhe të kursit të këmbimit të cilat janë rreziqe të humbjes apo zhvlerësimit të aseteve të bankës që rrjedhin nga luhatjet në normat e interesit ose kurset e këmbimit. Funksioni ALM nën Departamentin e Financave monitoron këto rreziqe.



Projekte të Rëndësishme



Pas mbylljes me sukses të fazës së "Bashkimit Ligjor" me Alpha Bank dhe të disa projekteve strategjikë të Bankes gjatë vitit 2022, fokusi gjatë vitit 2023 ishte faza e dytë e projektit, e cila konsistoi në "Bashkimin Teknologjik", me migrimin dhe unifikimin e të gjithë sistemeve të IT, pa lënë mënjanë projekte të tjerë strategjikë dhe realizimin e tyre me sukses.

Në kete fazë të "Bashkimit Teknologjik" u realizuan: "**Transferimi i Data Center"** nga ambientet e Alpha Bank në Athinë, në ambientet e OTP Bank Albania në Tiranë, si dhe **"Unifikimi i të gjithë sistemeve të IT"**. Kjo fazë e dytë e bashkimit përfundoi me sukses në dhjetor të vitit 2023.

Ndër arritjet kryesore të kësaj faze vlen të përmenden:

- Ngritja e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e aplikacioneve të ndryshme;
- Transferimi nga Athina në Tirane i të gjithë aplikacioneve dhe bazave të të dhenave, pa ndërprerë vijueshmërinë e punës në rrjetin e degëve dhe shërbimet online;
- Përshtatja dhe përmirësimi i proceseve dhe produkteve të Bankës;
- Ribrandimi i kartave të debitit dhe kreditit për të gjithë kartëmbajtësit që vinin nga Alpha Bank;
- Garantimi i vazhdimësisë së raportimeve ndaj autoriteteve lokale dhe në nivel Grupi OTP;

• Migrimi i të dhenave dhe unifikimi i Core Banking System, si edhe i sistemeve të tjerë të IT-së, si ai i Kredidhënies, Collection, Swift-it, Raportimeve, etj.;
• Unifikimi i të gjitha kontratave dhe dokumentacionit bankar të klientëve;
• Migrimi dhe unifikimi i platformës së Online Banking, Web dhe Mobile;
• Migrimi dhe unifikimi i Procesorit të Kartave për kartat e debitit dhe të kreditit;
• Rishikimi i të gjitha procedurave për t'u përshtatur me sistemet e unifikuara;
• Trajnimi i të gjithë stafit të Bankës per t'u përshtatur me sistemet dhe proceset e reja;
• Realizimi i Go-live brenda afatit të 3 ditëve, pa ndërprerë shërbimin e kartave të debitit dhe kreditit dhe me ndërprerje të shkurtër të shërbimit Online Banking.

Për të arritur qëllimin tonë final, në këtë projekt kanë qenë të përfshirë ngushtësisht më shumë se **100 punonjës**, rreth **15 menaxherë projektesh** dhe më shumë se 20 kompani ofruese shërbimesh.
Ky projekt nuk pati asnjë devijim nga data e paracaktuar prej më shumë se një viti e gjysmë më parë. Banka ishte plotesisht operative që në ditën e parë të Go-live dhe mbështetja gjatë ditëve të para për punonjësit dhe klientët u sigurua nëpërmjet përforcimit të Call Center, skuadrës së HelpDesk dhe monitorimit të përditshëm të problematikave.
Me krenari mund të përmendim që numri i çështjeve të ndeshura pas kalimit live, ishte plotësisht i menaxhueshëm dhe brenda pritshmërive. Numri i telefonatave në Call Center u normalizua që në fillim të javës së tretë, pas kalimit live dhe ato ishin kryesisht të lidhura me sherbimin e kartave dhe atë online.
Pavarësisht ngarkesës dhe fokusit drejt përfundimit të sukssesshëm të fazave kryesore të projektit të Bashkimit, gjatë këtij viti tepër intensiv janë mbyllur me sukses edhe iniciativa të tjera të rëndësishme si:
• Rikonstruksioni apo zhvendosja e rrjetit të degëve; Vlorë, Fier, Laprakë, Stacioni i Trenit, Bulevardi Zogu I, Stadiumi Dinamo, Sarandë, Lezhë, Lushnjë, Elbasan, Shkodër;
• Implementimi i aplikacionit për Shërbimin e Kujdestarisë së Titujve Shtetërorë;
• Implementimi i aplikacionit të Procesimit të Kredive "Loan Origination Tool", për kreditë me kolateral;
• Implementimi i platformës për grumbullimin dhe implementimin e ideve inovatore;
• Përditësimi i databazës së procedurave dhe rregulloreve të Bankës, si dhe rishikimi i proceseve të brendshëm.

ÇFARË NA PRET NË 2024?

Me nje portofol prej më shume se 50 projekte, skuadra jonë është përkushtuar intensivisht që përgjatë vitit 2024 të sigurojë implementimin e një sërë projektesh strategjikë që kanë në fokus eksperiencën e klientëve tanë. Ndër ta mund të përmendim:
- Këmbimi Dinamik i Valutave në ATM dhe POS;
- Aplikimi i monedhës Euro në POS;
- Implementimi i E-Wallet dhe E-Commerce;
- Ofrimi i Pagesave të Ujesjelles Kanalizime, në rrethe;
- Përmirësimi i procesit të kredidhënies për kredinë hipotekore dhe overdraftin;
- Ofrimi i Pagesave të E-Albania;
- Implementimi i PSD2 për Bankingun e Hapur;
- Përmiresimi i vazhdueshëm i rrjetit të Degëve;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i shportës së proceseve si: Kredia Hipotekore, Rinovimi i OVD, Kreditë e Biznesit Korporatë, Rinovimi i Limiteve të Kredidhënies, si dhe procese të tjera.

Ndërkohë, po kaq të rëndësishme janë edhe iniciativat që lidhen me përmirësimin dhe automatizimin e proceseve të brendshme. Të tillë janë përmirësimi i aplikacionit të procesimit të kredive, përforcimi i sistemeve të sigurisë, upgrade i sistemeve bankare, përfundimi i projektit "New Home", ndërtimi i platformave inovative për raportimet e brendshme, implementimi i platformës së inovacionit, etj.



Siguria Bankare

Banka OTP Albania aplikon një sërë masash kontrolli administrative, logjike dhe fizike për të mbrojtur sistemet tona të Teknologjisë së Informacionit (TI), ku ruhen dhe përpunohen të dhënat.
Në kuadër dhe të vigjilencës së shtuar përkundrejt, veçanërisht Sigurisë Kibernetike, e cila ishte dhe kryefjala gjatë vitit 2023, Banka i rishikoi në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me këshillat e Autoritetit për Sigurinë Kibernetike (AKCESK) këto masa, duke i përmirësuar dhe pasuruar.

Aksesi në sistemin tonë është i mundur vetëm bazuar në një proces të menaxhimit të autorizimit të paracaktuar. Menaxhimi i përdoruesit, identifikimi dhe menaxhimi i fjalëkalimit kontrollohen nga politikat tona dhe auditohen rregullisht.

Vëmendje e veçantë iu dedikua përdoruesve me të drejta të privilegjuara, duke i kompletuar me faktorë të dytë edhe kur aksesi është brenda rrjetit.
Nga ana tjetër, garantohet konfidencialiteti, disponueshmëria, integriteti i të dhënave me një mbrojtje të vazhdueshme përmes përditësimeve të aplikuara, në të gjithë sistemet tona.

Në linjë me planifikimin vjetor dhe me parimin e mbrojtjes në thellësi (Security in Depth), u implementuan sisteme të reja me teknologji moderne, si dhe u shtuan shërbime të jashtme të monitorimit në rrjetin jo publik (Dark Web), që plotësojnë më tej tërësinë e sistemeve të sigurisë.

Gjithashtu, u zëvendësua dhe sistemi i monitorimit të ngjarjeve të teknologjisë së informacionit (SIEM), në një sistem më modern, në linjë dhe me strategjinë e Grupit OTP, duke shtruar rrugën për lidhjen me shërbimet 24/7 më cilësore dhe të qendërzuara të Grupit, në këtë drejtim.

Falë punës së përkushtuar të ekipit të Sigurisë Kibernetike, shpesh të angazhuar me detyra të shtuara dhe gjatë fundjavës, në linjë me këshillat e Autoritetit për Sigurinë Kibernetike (AKCESK), u arrit të implementohet me sukses strategjia e lartpërmendur duke arritur të mos kemi incidente kibernetike, si dhe duke mbajtur kështu të pacënuar të dhënat dhe sistemet.

Operacioni ynë i instrumenteve të monitorimit kundër mashtrimit me karta, përditësohet vazhdimisht me rregulla të reja dhe ne arritëm sërish të përmirësojmë më tej nivelin tonë të mbrojtjes nga mashtrimi, pavarësisht rritjes së vazhdueshme të volumeve të kartave, (këtë herë edhe falë bazës më të gjerë të klientëve).


Ne parandaluam +200% më shumë krahasuar me një vit më parë, si dhe arritëm të rekuperonim mbi 90% të volumit të transaksioneve (krahasuar me 80% të një viti më parë), kryer nga vetë klientët, si rezultat i rënies pré ndaj skemave të ndryshme të mashtrimeve me karta.

Vëmendje të shtuar i kushtuam në vijimësi edhe ndërgjegjësimit të klientëve me fushata të dedikuara në rrjetet sociale, si edhe me broshura fizike me qëllim edukimin për përdorimin e sigurt të kanaleve të bankës, si dhe mbrojtjen nga rreziqet e jashëtme të shtuara.

Banka, në mbështetje të strategjisë së Grupit OTP dhe bazuar ne standardet e tij ka rinovuar plotësisht sistemet e sigurisë fizike, në disa degë. Gjithashtu, ka udhëhequr dhe mbikëqyrur me kujdes nën kontraktorët e Sigurisë Fizike, si të ruajtjes ashtu dhe të transportit të vlerave, duke mos pasur asnjë incident.

Operacionet e lëvizjeve të Cash-it, u kryen me efektshmëri maksimale, duke përmbushur nevojat e çdo klienti në çdo kohë dhe gjithashtu duke monitoruar me rigorozitet të vazhdueshëm limitet dhe përputhshmërinë me procedurat.

Duhet theksuar se viti 2023 ka qenë një vit rekord për sa i perket volumeve të parasë në cash, si për Bankën tonë, ashtu edhe në rang kombëtar sipas autoriteteve, lidhur kjo me efektin e turizmit, e jo vetëm.



Departamenti i Burimeve Njerëzore

Departamenti i Burimeve Njerëzore ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e funksionimit efikas dhe të qëndrueshëm të Bankës, nëpërmjet përzgjedhjes dhe punësimit të punonjësve, trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të tyre, si dhe menaxhimit të performancës së punonjësve. Ky departament është angazhuar maksimalisht nën përgjegjësinë e tij për të siguruar një ambient pune produktiv dhe motivues, duke kontribuar në rritjen e performancës dhe përmbushjen e objektivave të bankës.

Viti 2023 ishte sa sfidues aq edhe i suksesshëm në aspektin e aktivitetit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, në Bankën OTP Albania. Përgjatë vitit 2023, aktiviteti i këtij departamenti u përqendrua në pesë fushat kryesore të veprimtarisë si:

- Projekti Eagle – Bashkimi teknik i dy bankave;
- Rekrutimi dhe Promovimi;
- Zhvillimi i Punonjësve;
- Angazhimi dhe Motivimi;
- Employer Branding.

PROJEKTI EAGLE

Pas përfundimit të bashkimit ligjor mes dy bankave, Projekti Eagle vazhdoi duke mundësuar bashkimin teknik të sistemeve, bazave të të dhënave dhe zhvillimeve të mëtejshme të sistemit të Bankës. Projekti vijoi përgjatë gjithë vitit 2023 dhe kontributi i Departamentit të Burimeve Njerëzore ishte i domosdoshëm përgjatë gjithë procesit duke kontribuar për:


1. Menaxhimin e ndryshimit;
2. Rritjen e bashkëpunimit dhe përfshirjes së punonjësve të Bankës;
3. Trajnimin e punonjësve dhe pajisjen e tyre me dijet e mjaftueshme për të mundësuar shërbimin cilësor, që e karakterizon Bankën OTP Albania;
4. Motivimin e punonjësve të Bankës për përfundimin me sukses të projektit;
5. Komunikimin e vazhdueshëm dhe transparencën e plotë, për çdo proces që ndodhi në Bankë.

REKRUTIMI

Procesi i rekrutimit në Bankë është shumë i rëndësishëm për sigurimin e punonjësve kompetentë dhe të përshtatshëm për të përballuar sfidat gjithnjë e në rritje në tregun bankar. Sektori i rekrutimit është angazhuar në vazhdimësi në identifikimin, intervistimin, përzgjedhjen si dhe promovimin e kandidatëve potencialë, nëpërmjet një procesi të drejtë dhe transparent.

Gjatë vitit 2023 edhe pse Banka ishte në fazën e bashkimit teknik dhe finalizimit të bashkimit të plotë me Alpha Bank Albania, fokusi ynë vijoi të jetë promovimi i punonjësve të brendshëm dhe rritja e tyre profesionale në pozicione të reja, me më shumë sfida e risi. 102 punonjës u promovuan në pozicione të reja brenda Bankës duke garantuar ruajtjen dhe zhvillimin e njohurive, staf të përgatitur dhe të aftë për të përballuar sfidat dhe të mundësojë arritjen e dëshiruar të objektivave.

Nëpërmjet Programit të Praktikës të ofruar për studentët e sapo diplomuar, Banka OTP Albania ofron mundësi zbulimi dhe zhvillimi të talenteve të reja, si dhe jep kontributin e saj në formimin e brezave të ardhshëm të bankierëve.



Mosha mesatare e punonjësve
të Bankës OTP Albania është 36 Vjeç.

Zhvillimi i Punonjësve

Në Bankën OTP Albania, ne besojmë fort në zhvillimin e punonjësve. Perveç këshillave të vazhdueshme dhe feedback-ut të ofruar nga menaxheri i tyre, të gjithë punonjësit tanë kanë akses për trajnime në vendin e punës dhe një shumëllojshmëri mjetesh dhe burimesh. Këto përfshijnë akademi të ndryshme, programe personale zhvillim, trajnime/seminare të ndryshme, etj.

Procesi ynë i Performancës ndihmon të identifikohen objektivat e zhvillimit dhe aspiratat e karrierës dhe krijon një plan veprimi për t'i arritur ato. Menaxherët gjenden pranë gjatë gjithë procesit, duke ndihmuar të përmbushen dhe tejkalohen objektivat e performancës. Banka jep mbështetjen dhe burimet që nevojiten për të ndërtuar njohurite, rritur aftesitë, fituar përvojë dhe arritur qëllimet afatshkurtra e afatgjata, për një karrierë te suksesshme.

Zhvillimi i punonjësve ka qenë dhe mbetet prioritet i Bankës OTP Albania. Duke nisur nga Janari i vitit 2023, Departamenti i Burimeve Njerëzore zhvilloi dhe zbatoi planin e trajnimeve për të gjithë punonjësit e Bankës duke u përqendruar në zhvillimin e aftësive shitëse, zhvillimin e aftësive teknike të analizave financiare, apo të produkteve të reja të Bankës.

Përgjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2023, Departamenti i Burimeve Njerëzore ndërmori fushatën e trajnimeve masive për të gjithë punonjësit e Bankës OTP Albania, për përditësimin e njohurive. Kjo fushatë trajnimesh kishte si qëllim njehsimin e shërbimit të klientit, si dhe aftësitë teknike të stafit në të gjithë funksionet e Bankës. Pergjatë bashkimit teknik njohuritë në sistemin e ri bankar që Banka do të vendoste në zbatim në Nëntor 2023, ishin të domosdoshme të përçoheshin.

Gjatë vitit 2023, trajnimet për punonjësit e Bankës OTP Albania u fokusuan kryesisht në temat e mëposhtme:

- Trajnimet tematikore mbi funksionalitetet e reja në Bankë dhe zhvillimin e produkteve digjitale;
- Forcimi i kulturës së riskut dhe analizave financiare;
- Nxitja e bashkëpunimit me punonjësit e rinj;
- Parandalimi i Pastrimit të Parave;
- Përmirësimi i përvojës së klientit;
- Zhvillimi i kulturës menaxheriale;
- Rritja e eficiencës komerciale;
- Nivelimi i njohurive mbi sistemet kompjuterike, proceseve dhe procedurave të Bankës.

Të dhënat e përgjithshme të trajnimeve për vitin 2023, prezantohen ne tabelën e mëposhtme:

	2021	2022	2023
Numri total i Orëve të Trajnimit	14,045	28,411	30,571
Numri total i Ditëve të Trajnimit	1,756	3,552	3,820
Numri i punonjësve të trajnuar, të paktën një herë	469	776	748
Numri mesatar i orëve të trajnimit, për punonjës	29.6	36.6	40.9

Në lidhje me zhvillimin e punonjësve të Bankës OTP Albania, krahasuar me vitin 2022, gjatë vitit 2023, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka realizuar një rritje me gati 7.6% në numrin total të orëve të trajnimit.

ANGAZHIMI DHE MOTIVIMI

Punonjësit tanë janë ekipi që zbaton strategjinë dhe mundëson që Banka OTP Albania të ecë përpara. E kështu, u kujdesëm që gjatë vitit 2023 të mos ndalonim organizimin e aktiviteteve të ndryshme, për ta dhe fëmijët e tyre, për të rritur më tej angazhimin dhe motivimin e punonjësve si dhe për të mbështetur pasionet, idetë dhe dëshirat e tyre. Përkushtimi i secilit pjesëtar të ekipit të Bankës OTP Albania dhe frymës së skuadrës në Bankë, na mundësuan të kemi nivelin e angazhimit të punonjësve ndër më të lartët nga të gjithë entitetet e Grupit OTP në rajon.

EMPLOYER BRANDING

Banka OTP Albania i jep një rëndësi të veçantë marrëdhënieve që ka me institucionet e edukimit të lartë dhe studentët e fakulteteve të ndryshme. Këto institucione arsimore janë burimi i kandidatëve cilësorë, potencial për t'u bërë pjesë e ekipit të Bankës sonë.
Gjatë vitit 2023, Departamenti i Burimeve Njerëzore të Bankës OTP Albania u angazhua ne aktivitete të shumta me këto institucione, si: panaire të punës organizuar nga universitetet, zhvillimi i leksioneve të hapura me temën: "Aftësitë e nevojshme për të ardhmen në tregun e punës", etj.

Në kuadër të rritjes së brandit të Bankës OTP Albania për të qenë punëdhënës tërheqës në tregun shqiptar dhe njëkohësisht, për të vlerësuar dhe kandidatë të mundshëm cilësorë që mund të bëhen pjesë e ekipit të Bankës sonë, Departamenti i Burimeve Njerëzore organizoi Edicionin e Katërt të Konkursit për Research Paper më të mirë, duke ftuar të marrin pjesë studentë nga të gjithë universitetet dhe fakultetet shqiptare.

POLITIKA E SHPËRBLIMEVE

Qëllimi i përdorimit të skemës së shpërblimit për punonjësit e Bankës OTP Albania, është arritja e targeteve dhe objektivave të vendosur nga supervizori i tyre. Skema e shpërblimeve ka si qëllim të shtojë rezultatet e punonjësve dhe cilësinë e shërbimit dhe produkteve, në mënyrë që të rriten rezultatet e gjithë Bankës.

Të gjithë punonjësit e Bankës janë pjesë e një skeme shpërblimi, bazuar në pozicionin përkatës. Në rast se një punonjës është pjesë e një skeme, ai nuk mund jetë pjesë e një skeme tjetër shpërblimi në Bankë.

Përbërësit e shpërblimeve në Bankën OTP Albania, janë ndarë në tre komponentë:
1. Paga bazë (fikse)
2. Paga variable
3. Përfitime të tjera

1. PAGA BAZË

a. Përcaktimi i pagës bazë për punonjësit lidhet me elementët si më poshtë:

- Përgjegjesitë e pozicionit dhe aftësitë profesionale që kërkohen për këtë pozicion;
- Ruajtje e nje niveli page konkurues në treg;
- Eksperiencën e punonjësit në këtë pozicion;
- Strukturën e gradës për këtë pozicion;

b. Ndërkohë rritja e pagës bazë për punonjësit, lidhet me plotësimin e kritereve si më poshtë :

- Performanca e punonjësit;
- Niveli i pagës së punonjësit, krahasuar me nivelin e pagës sipas gradës;
- Buxheti vjetor i përcaktuar për rritjen e pagave;
- Promovimi i punonjësit në një pozicion me përgjegjësi më të madhe;
- Periudha që ka kaluar nga rritja e fundit e pagës.

Pagat bazë për Bordin e Menaxhimit, përcaktohen sipas politikave të Grupit OTP Bank.

2. PAGA VARIABËL

Paga variabël është e lidhur me rezultatet e performancës vjetore të punonjësve dhe shitjet e kryera. Procesi i vlerësimit të performancës së stafit kryhet çdo vit, i ndarë në dy pjesë: vlerësimi cilësor dhe vlerësimi sasior.

Bonusi për forcën shitëse bazohet në shitjet e realizuara gjatë tremujorëve. Bonusi i shpërndahet çdo tremujor forcës shitëse, bazuar në rezultate (katër herë në vit).

Bonusi për stafin suport të Drejtorisë së Përgjithshme shpërndahet një herë në vit, bazuar në performancën vjetore pa tejkaluar buxhetin e akorduar për këtë bonus.

Sipas politikës së shpërblimeve të Grupit OTP Bank, Drejtuesit Ekzekutivë dhe disa pozicione të tjera drejtuese përfitojnë bonus bazuar në: pozicionin e tyre, performancën dhe në një përqindje të përcaktuar për çdo pozicion. Pozicionet që përfshihen në këtë kategori, përcaktohen sipas kritereve të Grupit OTP Bank.

Këshilli Drejtues shpërblehet me një pagesë fikse mujore.

3. PËRFITIME TË TJERA

Përfitime të tjera mund të jenë në formë monetare ose jo monetare, si më poshtë:

- Shpërblim për leje lindje;
- Kontroll mjekësor;
- Norma preferenciale për produktet e kredisë;
- Paketa telefonike;
- Dieta për udhëtime;
- Karburant
- Aktivitete Team Building;
- Dhurata për fëmijet në vitin e ri.

Format dhe elementet e shpërblimit për Drejtues Ekzekutiv (çdo fund viti) (shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin fiskal	E menjëhereshme / për periudhën aktuale, 2023	Për periudha të kaluara, 2022
Elemente të pandryshueshëm të shpërblimit	157,009	127,929
Cash/bonus	157,009	127,929
Aksione		
Të tjera		
Elemente të ndryshueshem të shpërblimit	32,613	22,463
Cash/bonus		
Aksione		
Të tjera	32,613	22,463

Format dhe elementet e shpërblimit për Këshillin Drejtues (çdo fund viti) (shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin fiskal	E menjëhereshme / për periudhën aktuale, 2023	Për periudha të kaluara, 2022
Elemente të pandryshueshëm të shpërblimit	10,911	8,492
Cash/bonus	7,254	4,092
Aksione		
Të tjera		
Elemente të ndryshueshem të shpërblimit		
Cash/bonus		
Aksione		
Të tjera		

Përgjegjësia Sociale e Korporatës



DONACIONE PËR FAMILJET NË NEVOJË.

Në mbështetje të shtresave në nevojë Banka OTP Albania organizoi një aktivitet me qëllim mbledhjen e donacioneve në kutitë e gjelbra të vendosura në godinën e zyrave qendrore të saj.

Të gjithë donacionet që u mblodhën (ushqime dhe lodra për fëmijë), u paketuan dhe u shpërndanë në 11 familje të ndryshme, në bashkëpunim me Organizatën World Vision, jo vetëm si një akt bamirësie, por edhe si një kontribut financiar.





DHURATAT E FUNDVITIT PËR FËMIJËT NË NEVOJË.

Me dëshirën e mirë për t'u qëndruar pranë fëmijëve përgjatë sezonit festiv, Banka OTP Albania, përmes angazhimit të stafit të saj kontribuoi për blerjen e disa dhuratave (lodra), për fëmijët në nevojë.
Në bashkëpunim me organizatën World Vision, lodrat që u mblodhën u shpërndanë përgjatë festave tek disa fëmijë të familjeve në nevojë, në qytetin e Prrenjasit.



BANKA OTP ALBANIA NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË BUJQËSISË, LUSHNJE.

"AGRICULTURE DAYS"

Panairi i Bujqësisë një aktivitet tashmë me përmasa ndërkombëtare, ka bërë bashkë biznese bujqësore si dhe fermerë nga Shqipëria, Kosova dhe rajoni përgjatë datave 27-29 prill, 2023, në qytetin e Lushnjes.

Pjesë e kësaj platforme bashkëpunimi, e cila synon të promovojë dhe mbështesë bujqësinë e qëndrueshme, ka qenë edhe Banka OTP Albania.

Agroturizmi, Bujqësia, Blegtoria dhe Agropërpunimi, janë përherë në fokus të produkteve të ofruara nga Banka OTP Albania, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin të infrastrukturës, apo kapaciteteve financiare të fermerëve shqiptarë.

DHURIMI I GJAKUT PËR FËMIJËT TALASEMIKË.



Banka OTP Albania ka kontribuar për një nga kauzat më të rëndësishme në fushën e mjekësisë pediatrike, siç është mbështetja e fëmijëve me talasemi. Stafi i Bankës ka marrë pjesë gjatë muajit korrik, 2023 në aksionin e dhurimit vullnetar të gjakut, si një shprehje jo vetëm e përgjegjësisë sociale, por edhe si një asociim me një problematikë që konsiderohet edhe si kauzë personale.

"LUFTOJMË SË BASHKU KANCERIN E GJIRIT" .

DONACION PËR SHOQATËN ORTUS

Banka OTP Albania ka synimin që të thellojë angazhimin në mbështetje të kauzave me impakt të gjerë, në fushën e shëndetit dhe sidomos atë të gruas. E tillë është lufta ndaj kancerit të gjirit, e cila ka qenë në fokus të Konferencës së organizuar nga Shoqata Ortus.
Për t'i dhënë një impakt më të gjerë kësaj çështje, si edhe për t'a mbështetur përhapjen e informacionit edukues për diagnostikimin e kancerit të gjirit në kohën e duhur, Banka OTP Albania ka dhënë kontributin e vet financiar, në organizimin dhe promovimin e këtij aktiviteti.



NË MBËSHTETJE TË FUSHATËS KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT.

SHOQATA KRISTIANE E GRAVE SHQIPTARE

Banka OTP Albania i bashkohet "Fjongos Rozë" në kuadër të mbështjes së fushatës kundër kancerit të gjirit të lançuar nga YWCA – Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare. Në dt. 23 tetor, 2023 shoqata YWCA ka inicuar një marshim nën thirrjen: "Ejani të ecim së bashku". Në kuadër të sensibilizimit për këtë kauzë, stafi i rrjetit të degëve të Bankës OTP Albania iu bashkua fushatës duke mbajtur fjongon rozë përgjatë gjithë muajit tetor, i cili identifikohet edhe si muaji i luftës ndaj kancerit të gjirit.

PJESËMARRJA E PUNONJËSVE TË BANKËS OTP ALBANIA NË MARATONËN E TIRANËS



Pjesëmarrja në këtë aktivitet sportiv ndërkombëtar është kthyer tashmë në një traditë për stafin e Bankës OTP Albania. Këtë vit pjesëmarrja ishte më e lartë krahasuar me vitet e tjera duke provuar edhe njëherë dëshirën e mirë të punonjësve për angazhimin në aktivitete me fokus promovimin e jetesës së shëndetshme dhe shpirtit të garës.



BANKA OTP ALBANIA NË MBËSHTEJE TË JAVËS SË PARASË.

Banka OTP Albania ka mbështetur Shoqatën Shqiptare të Bankave gjatë aktivitetit **Java e Parasë - "Administro paratë e tua, kultivo të ardhmen"**, në kuadër të promovimit të fushatës për edukimin financiar dhe nxitjen e shipirtit sipërmarrës tek të rinjtë.
Në kuadër të këtij aktiviteti janë ofruar 3 çmime për të rinjtë e angazhuar në përcjelljen e këtij mesazhi, të cilët u përzgjodhën mes punimeve të tjera video, të dorëzuara.

KONTRIBUT PËR PAGESËN E TARIFËS SHKOLLORE PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA.

OTP Bank Albania ka në fokus arsimin si një prej fushave me rëndësi për përgjegjësinë sociale të korporatës. Në këtë kuadër, **Grupi i Vullnetarëve të bankës "Green Hearts"**, u angazhua për mbledhjen e fondeve në ndihmë të studentëve me pamundësi ekonomike, të cilët studiojnë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Qëllimi i këtij kontributi financiar ishte mbulimi i shpenzimeve të tarifës shkollore të studentëve, në mënyrë që ata të mos ndërprisnin studimet. Me anë të këtij angazhimi u arrit të sigurohej vijimësia e ndjekjes së studimeve për disa studentë.



OTP BANK ALBANIA PËRMIRËSON AKSESIN NË EDUKIM.

DHURIMI I NJË KËNDI STUDIMI DHE KOMPJUTERI.

Në vijim të angazhimit për përmirësimin e aksesit në arsim për të rinjtë me nevoja ekonomike, Banka OTP Albania ka ofruar mbështetjen e saj për pajisjen me një kënd studimi dhe kompjuter për një ndër fëmijët që nuk kishte mundësi financiare të përballonte këto kosto, duke realizuar kështu dëshirën për kushte sa më komode studimi.

SHITJA E PIKTURAVE PËR FËMIJËT E "QYTEZËS SË FËMIJËVE NË KORÇË".



Banka OTP Albania, përmes kontributit të vetë stafit angazhohet jo vetëm në aktivitetet e përgjegjësisë sociale, por përfshihet edhe në fusha të ndryshme artistike si një shprehje e krijimitarisë dhe individualizmit. Projekti u bë i mundur nga fëmijët e stafit të bankës, të cilët pikturuan tablo të ndryshme artistike.
Dhjetra pikturat e mbledhura u ekspozuan në ambientet e Zyrave Qendrore dhe me anë të një mini-ankandi, u arrit të grumbullohej një fond, i cili shkoi në mbështetje të fëmijëve të "Qytezës së fëmijëve në Korçë", për ndjekjen e kurseve artistike.



"BANKA OTP ALBANIA PARTNERE ME UN WOMEN PËR ELEMINIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE.

Angazhimi i Bankës OTP Albania në fushat e përgjegjësisë sociale të korporatës nuk kufizohet vetëm në disa fusha siç janë zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, shoqëror apo mjedisor. Sikundër ndërgjegjësimi i shoqërisë civile në Shqipëri nuk mund të jetë një çështje që i takon vetëm organizatave, apo institucioneve publike.
Barazia gjinore, fuqizimi i grave dhe vajzave përbën një angazhim të cilin Banka OTP Albania tashmë e ka konkretizuar duke u kthyer në një partnere firmëtare të marrëveshjes me organizatën e UN Women, me synimin e Eleminimit të Dhunës ndaj Grave. Ky angazhim është konkretizuar menjëherë duke iu bashkuar fushatës ndërkombëtare vjetore, **"16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave."** Kjo fushatë, e cila u zhvillua përgjatë periudhës 25 nëntor – 10 dhjetor, 2023 u promovua edhe në rrjetin social të bankës përmes postimeve, që synonin përfshirjen nga publiku i gjerë, si edhe nga stafit i bankës duke e bërë sa më virale fushatën përmes hashtag identifikues **#AsnjeJustifikim**



OTP BANK ALBANIA PJESËMARRËSE NË "PANAIRIN E ENERGJISË, NDËRTIMIT DHE EKONOMISË SË GJELBËR".

Panairi i Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër, i organizuar në datat 5-6 tetor, 2023 u mundësoi ndërveprim prodhuesve dhe furnitorëve të teknologjive të cilët prezantuan, por edhe u njohën me produktet dhe shërbimet më inovative nga industria e energjisë dhe e ndërtimit.
Banka OTP Albania u prezantua në këtë aktivitet jo vetëm me stendë, por gjithashtu u aktivizua edhe në panelin e diskutimeve me temën: **"Sfidat për rritjen e peshës së vetëprodhimit të energjisë fotovoltaike në Shqipëri."** Banka OTP Albania është angazhuar që në vijim të vitit 2024 të lançojë produkte të dedikuara të kredisë për sistemet fotovoltaike, si pjesë e angazhimit në sigurimin e aksesit për energji të qëndrueshme.

MBËSHTETJE E "FESTËS SË BIRRËS", KORÇË.

Banka OTP Albania ka mbështetur për të disatin vit rradhazi eventin përfaqësues tashmë të qytetit të Korçës dhe të turizmit lokal në Shqipëri, "Festa e Birrës".
Si një traditë 17 vjeçare, ky aktivitet i organizuar në pikun e sezonit turistik, është kthyer në podiumin promovues të shumë produkteve ushqimore vendase, ku hapësirën kryesore e zënë prodhuesit shqiptarë të birrës.





NË MBËSHTETJE TË FUSHAVE NË ZHVILLIM:"EQUOS HIPIZËM" – GARA E KAPËRCIMIT ME KUAJ

Banka OTP Albania stimulon vazhdimisht fusha të ndryshme të ekonomisë, apo të industrive në zhvillim në vend. Sporti dhe mirëqenia nuk janë vetëm aspekte të mirëqenies dhe shëndetit. Ato mund të shkojnë përtej sporteve, duke u kthyer në sektorë të qëndrueshëm ekonomikë, nëse promovohen dhe mbështeten iniciativat ekzistuese.
E tillë ka qenë dhe Gara e Hipizmit e organizuar nga Federata Shqiptare e Sporteve të Hipizmit, në bashkëpunim me Equos Resort. Në këtë aktivitet Banka OTP Albania ka kontribuar jo vetëm financiarisht, por edhe në promovimin e një sektori ekonomiko-sportiv, tashmë në zhvillim.



MBËSHTETJA E START-UP NGA OTP BANK ALBANIA.

Përgjatë muajit maj, 2023 Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ka organizuar aktivitetin "Young Innovators", në kuadër të mbështetjes së ideve inovatore dhe bizneseve start up.
Banka OTP Albania mbështeti këtë aktivitet duke qenë pjesëmarrëse në jurinë që përzgjodhi idetë më të mira.

OTP BANK ALBANIA NË MBËSHTETJE TË SHOQATËS SË TË VERBËRVE.

Sigurimi i një aksesi të barabartë me spektër të gjerë në fushën e arsimit, por edhe më ngushtë tek komunitetet e personave me aftësi të kufizuara, mbetet në fokus të aktiviteteve të Përgjegjësisë Sociale në Bankën OTP Albania. Për komunitetin e personave të verbër mungesa e autonomisë në lëvizje, vështirësia për akses në informacion, vazhdon të krijojë barriera të larta në aspektin e edukimit.
Për të mbështetur sa më shumë këtë komunitet Banka OTP Albania ka kontribuar financiarisht për Shoqatën e të Verbërve në Shqipëri me qëllimin blerjen e audio books, si dhe pasurimin e Bibliotekës Kombëtare të të Verbërve.

KONTRIBUT NË GALANË E BAMIRËSISË OTP BANK ALBANIA MBËSHTET KRYQIN E KUQ SHQIPTAR.



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit në dt. 5 dhjetor 2023, Kryqi i Kuq Shqiptar organizoi një mbrëmje bamirësie në të cilën Banka OTP Albania u bashkua për të dhënë kontributin financiar në ndihmë të nismave humanitare.
Në përfundim të kësaj mbrëmjeje, u çel një ekspozitë pikturash me punimet e vullnetarëve. Fondet e mbledhura nga shitja e pikturave shkuan në ndihmë të fëmijëve në nevojë, që nuk flasin, nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.



MBJELLJA E PEMËVE MANJOLË NË RRUGËN YMER KURTI, TIRANË.

Banka OTP Albania ka në prioritet plotësimin në të gjithë format përmirësimin e cilësisë së jetës ku vend kryesor zë edhe krijimi i hapësirave të gjelbra.

Në shkurt, 2023 u dha një kontribut financiar i cili shkoi në mbështetje të gjelbërimit të Rr. "Ymer Kurti" në Tiranë, në të cilën u mbollën një sasi e konsiderueshme rrënjësh të pemës manjolë.



OTP BANK ALBANIA DHURON PËR QYTETIN E SHKODRËS. *"TOTE BAGS" TË PIKTURUARA*

Disa "Tote bags" janë pikturuar me bojëra speciale nga fëmijët e stafit të Bankës OTP Albania dhe janë shitur. Donacionet nga shitja e tyre shkuan për mbjelljen e pemëve në qytetin e Shkodrës.
Fëmijët bashkë me stafin e bankës janë angazhuar personalisht që ky aktivitet të kishte sukses, jo vetëm në mbjelljen e pemëve, por edhe në mesazhin që përcjell për t'u kujdesur më shumë për mjedisin në të cilin jetojmë.

KONTRIBUT PËR PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË SIGURISË PUBLIKE, VLORË.

OTP Bank Albania konsideron me rëndësi jo vetëm angazhimin për mbrojtjen e mjedisit, por edhe rritjen e cilësisë së sigurisë së qytetarëve. Ky angazhim është konkretizuar duke mbështetur financiarisht Drejtorinë e Policisë së qytetit të Vlorës në blerjen e kamerave të sigurisë. Ndërtimi i një infrastrukture të avancuar të sigurisë qytetare është një çështje në interes të gjerë publik, por e cila përbën një nga shtyllat e përgjegjësisë sociale në angazhimet CSR të OTP Bank Albania.

KONTRIBUT PËR DREJTORINË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME, ELBASAN.

Në vijim të angazhimit për përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës së institucioneve publike, Banka OTP Albania mbështeti Drejtorinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime në Elbasan, nëpërmjet blerjes të një sasie kompjutera dhe printera.



DHURIMI I LIBRAVE DHE PASURIMI I BIBLIOTEKËS, GRAMSH.

Banka OTP Albania, u angazhua përmes grupit të vullnetarëve "Green Hearts" në aktivitetin e përgjegjësisë sociale të dhurimit të 200 librave të kategorive të ndryshme, të dedikuar për bibliotekën e qytetit të Gramshit.
Përmes këtij akti dhurimi fëmijët e shkollës 9-vjeçare të këtij qyteti do të kenë mundësi aksesi në më shumë tituj dhe informacion të përditësuar.

DHURIMI I MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR INSTITUCIONET PUBLIKE.

Banka OTP Albania, ndër vite ka patur bashkëpunim të ngushtë me institucione të ndryshme dhe gjithmonë ka dhënë kontribut në zhvillimin e tyre. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023 janë dhuruar një sërë materialesh utilitare si mobilje dhe kompjutera, në institucione të disa rretheve të Shqipërisë me qëllimin për të përmirësuar kushtet e punës në veprimtarinë publike, si më poshtë:

- Mbështetje me mobilje për IEVP (Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale), Burrel.
- Mbështetje me mobilje për Bashkinë Memaliaj.
- Mbështetje me njësi kompjuterike për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Mirditë.
- Mbështetje kompjuterike për njësinë publike të Trajtimit të Studentëve, Elbasan.
- Mbështetje me mobilje për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime, Fier.
- Mbështetje me mobilje për Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare, Fier.
- Mbështetje me mobilje për Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare, Vlorë-Himarë.
- Mbështetje me mobilje për Zyrën Vendore Arsimore, Kurbin.
- Mbështetje me mobilje për Zyrën Vendore Arsimore, Pogradec.
- Mbështetje me mobilje për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Pogradec.

Materialet e dhuruara janë vënë në përdorim menjëherë duke kontribuar në një përmirësim të mjedisit të punës dhe shërbimit ndaj qytetarëve.

BANKA OTP ALBANIA MBËSHTET MOVEIT4SOS



Banka OTP Albania përmes nxitjes dhe iniciativës së Organizatës SOS / Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri, është bërë partner në projektin MoveIT4SOS, duke blerë të drejtën e përdorimit të këtij aplikacioni, ndërsa fondet e dhëna do të shërbejnë për vijimësinë e kujdesit që SOS ofron për fëmijët pa kujdes prindëror.

Projekti MoveIT4SOS pati si synim kryesor inkurajimin në zgjidhjen në mënyrën më të shëndetshme të lëvizjes duke motivuar stafin e OTP Bank për aktivitete fizike që janë të domosdoshme për ruajtjen e shëndetit të mirë e duke kontribuar pozitivisht në cilësinë e përgjithshme të ajrit. Dhe si qëllim kyç duke u ardhur në ndihmë fëmijëve dhe të rinjve pa kujdes prindëror që të rriten në një mjedis të sigurt, në familjet SOS.



MBJELLJA E PEMËVE NË QYTETIN E SHKODRËS.

Banka OTP Albania përmes stafit të saj ka kontribuar financiarisht për mbjelljen e 100 rrënjëve pemë të llojit Pisha në qytetin e Shkodrës.
Nismëtarë të kësaj inciative kanë qenë të vegjlit e stafit të bankës përmes shitjes së Tote Bags të pikturura më herët gjatë vitit 2023, të cilat janë shitur në mbështetje të këtij projekti mjedisor.



PASTRIMI I "KEPIT TË RODONIT"

OTP Bank Albania inicioi në muajin qershor, në kuadër të "Ditës Botërore të Mjedisit" aktivitetin e parë të grupit të vullnetarëve "Green Hearts".
30 punonjës të OTP Bank Albania, bashkë me fëmijët e tyre, u mblodhën për të pastruar një ndër plazhet më të bukura shqiptare, "Kepin e Rodonit.
Ky gur themeli ka hapur rrugën për zhvillimin e një sërë aktivitetesh të tjera përgjatë gjithë vitit, pjesëmarrës të të cilit janë staf i OTP Bank Albania që vullnetarisht kontribuojnë për një mjedis dhe komunitet të përmirësuar.

SPONSORIZIMI I FESTËS KOMBËTARE TË FRANCËS.

Banka OTP Albania beson në filozofinë se individët dhe organizatat mund të kontribuojnë në zhvillimin e objektivave të ndryshëm duke përfshirë këtu edhe ndërtimin e partneriteteve, shkëmbimeve kulturore, rritjes ekonomike etj. Në këtë kuadër Banka OTP Albania ka kontribuar financiarisht në aktivitetin e organizuar nga Ambasada Franceze, me rastin e Festës Kombëtare të Francës, më 14 Korrik,



JAVA E KULTURËS HUNGAREZE NË SHQIPËRI.

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve diplomatike Shqiptaro-Hungareze dhe të vlerësimit të kontributit ekonomik të shtetit hungarez përmes biznesit aktiv në Shqipëri, Ambasada Hungareze në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës organizuan në Nëntor, 2023 aktivitetin "Hungarissimo", kushtuar Javës së Kulturës Hungareze, në Shqipëri.
Banka OTP Albania në të njëjtën linjë të bashkëpunimit dhe dëshirës për të forcuar këto lidhje kontribuoi financiarisht në këtë aktivitet kulturor.

CEREMONIA E DIPLOMIMIT TË MATURANTËVE 2023.

Për ta kthyer ceremoninë e diplomimit për maturantët e qytetit të Himarës në një event të paharrueshëm, Banka OTP Albania ka mbështetur këtë aktivitet të organizuar nga Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare në këtë qytet.

OTP BANK ALBANIA PJESËMARRËSE DHE MBËSHTETËSE E "WESTERN BALKANS ESG SUMMIT", 2023.

Banka OTP Albania është në zhvillim të vazhdueshëm për sa i përket zbatimit të praktikave të përgjegjësisë sociale, duke synuar përmirësimin dhe rritjen e standardeve të biznesit të qëndrueshëm. Angazhimi në këtë aspekt kryhet edhe përmes pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare me fokus ESG, për të njohur dhe bashkëndarë praktikat më të mira.
"Western Balkans ESG Summit" është eventi i parë i kësaj natyre i organizuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
Samiti i cili u zhvillua në datat 26-28 Prill, 2023 në Porto Montenegro, Mal i Zi, ka bërë bashkë qeveritë, bizneset dhe ekspertët në fushën ESG, për të trajtuar çështjet më të rëndësishme të biznesit dhe financave të qëndrueshme.
Banka OTP Albania, përveç pjesëmarrjes, gjithashtu edhe ka kontribuar në organizimin e këtij aktiviteti.




OTP BANK ALBANIA MBËSHTET KONCERTIN ALBANIAN POP ROCK - IN MEMORIAM

Në mbështetje të artit dhe kulturës, Banka OTP Albania mbështeti organizimin e koncertit Albanian Pop Rock "In Memoriam", i cili u organizua në muajin maj 2023 dhe ku performuan këngëtarë të njohur shqiptarë në këtë zhanër. Nëpërmjet këtij eventi Banka përforcon mbështetjen e trashëgimisë tonë kulturore.

MBËSHTETJE E ORGANIZATËS "RRJETI I VULLNETARËVE SHQIPTARË"

Projekti "Shif e Bëj filma" nga organizata "Rrjeti i vullnetarëve shqiptarë", i cili u lancua përgjatë vitit 2023, kishte në fokus produksionin e filmave me metrazh të shkurtër. Banka OTP Albania e përqafoi menjëherë këtë projekt të bukur kinematografik, nëpërmjet mbeshtjes së dhënë për produksionin e dy prej këtyre filmave.



Përvoja e Klientit

Strategjia e Bankës OTP Albania gjate vitit 2023 ka vijuar me përqendrimin tek klientët dhe punonjësit pas procesit të bashkimit teknik, për të ofruar cilësi të lartë shërbimi dhe produkte të volitshme për ta, duke patur parasysh efektin që bashkimi i bankave shkaktoi.


Banka OTP Albania për të ruajtur pozitën e mirë ne treg përsa i takon eksperiencës së klientit, është angazhuar në përmirësimin e praktikave të monitorimit të Kënaqësisë së Klientit sipas proceseve dhe produkteve te ofruara. Per këtë qëllim është nënshkruar marrëveshja me kompani nënkontraktore kërkimesh e cila ka mundësuar skuadër të dedikuar për zhvillimin e anketimeve për të vlerësuar eksperiencën e klientit në cdo fazë të rrugëtimit të përbashkët.


Gjatë fundit të vitit 2023 janë zhvilluar kërkime për të kuptuar sjelljen dhe identifikuar cdo lloj impakti të shfaqur në te gjitha aktivitetet e prekura nga bashkimi teknik, si sherbimi i klientit, komunikimi I ndryshimeve, funksionaliteti I produkteve etj. Nëpërmjet këtij kërkimi kuptuam arsyet e reagimit të klientëve tanë, që më pas cuan në përmirësimin e disa elementëve të proceseve për t`i shtuar vlerë klientëve dhe inkurajuar vazhdimin e marrëdhënies me ne.

Një tjetër kërkim i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe u fokusua në monitorimin e hapit të parë të klientit me bankën, gjetjet e të cilit ndikuan në përmirësimin e ndërveprimit në pikënisjen e rrugëtimit për krijimin e nje bashkëpunimi të gjatë dhe të sigurt bazuar në besimin e ndërsjelltë.
Me anë të platformës On the Spot survey, ka vijuar të mblidhet në kohë reale kënaqësia e klientëve jo vetëm për veprimet e transfertave në degë, por tashmë edhe ajo për shërbimin e klientit pas cdo kontakti me skuadren e qendrës së kujdesit të klientit.

Bazuar në rezultatet e këtyre kërkimeve është ndërmarrë iniciativa e shpërblimit të punonjësve më të vlerësuar nga klientët, që tashmë kryhet në mënyrë periodike.

Për të pestin vit, Banka OTP Albania kreu një studim tregu në bashkëpunim me KANTAR, një institucion i njohur në këtë fushë. Qëllimi i kërkimit ishte matja e kënaqësisë dhe perceptimit të klientëve në lidhje me markën OTP, si dhe pritshmëritë e tyre lidhur me produktet dhe shërbimet. Ne ja dolëm të ruajm pozitën si banka me indeksin më të lartë TRiM, një tregues kryesor i performancës së kënaqësisë së markës, pavarësisht periudhës tranzitive të bashkimit.





Vëmendje e posaçme iu vu ndihmës për klientët edhe pas procesit të bashkimit teknik, i cili kërkoi angazhim të posaçëm nga banka, duke përforcuar skuadrën e Qendrës së Kontaktit si dhe Skuadrën e trajtnimit të ankesave. Ekipi i CX vijoi të ofrojë shërbim te përkushtuar në mënyrë që çdo ndryshim, të kalonte sa më butë. Jemi angazhuar plotësisht për t`iu përgjigjur në kohë ankesave apo kërkesave të klientëve lidhur me ndryshimet në të gjithë spektrin e ofrimit të shërbimit. Nga procesi i trajtimit të ankesave, në bashkëpunim me skuadrat e tjera kemi mundur të konstatojmë dhe sistemojmë problematika që kanë shoqëruar bashkimin e sistemeve bankare, duke parandaluar pakënaqësinë e klientëve në vijim.

Një projekt mjaft i rëndësishëm i fokusuar ekskluzivisht tek komunikimi me klientët, si dhe punonjësit e bankës së bashkuar, ishte ai i lancimit të Brandit të CX: Misionit, Vizionit si dhe Vlerave të Brandit. Publikimi i tyre forcoi mesazhin e përgjithshëm të CX për zotimin e bankës për të ofruar një eksperiencë unike, duke kombinuar teknologjinë, shumëllojshmërinë e shërbimeve, një frymë organizative bashkëpunuese, si dhe një marrëdhënie besimi dhe transparence.

Informacion i Detajuar

BANKA OTP ALBANIA SH.A.

Raporti i audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare në datën dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur
Pasqyra e pozicionit financiar 1
Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse 2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital 3
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare 4
1. Të përgjithshme 5
2. Baza e përgatitjes 5
3. Deklarata e përputhshmërisë 5
4. Paraqitja e pasqyrave financiare 5
5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese 6
6. Përmbledhje e politikave kontabël 7
7. Standartet e nxjerra por ende jo efektive 27
8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël 28
9. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre 33
10. Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore 34
11. Huatë dhe parapagime ndaj institucioneve financiare 34
12. Investime në letrat me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse 34
13. Hua dhe paradhënie për klientët, neto 35
14. Aktive të tjera 41
15. Aktive afatgjata materiale 42
16. Aktive me të drejtë përdorimi 43
17. Aktive afatgjata jomateriale 43
18. Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore 44
19. Detyrime ndaj institucioneve financiare 44
20. Detyrime ndaj klientëve 45
21. Detyrime të qirasë 46
22. Detyrime të tjera 47
23. Borxhi i varur 48
24. Provizionet për detyrimet dhe të tjera 48
25. Aktive tatimore te shtyra, neto 49
26. Kapitali aksionar 49
27. Rezerva 50
28. Të ardhura nga interesat me normë efektive të interesit 50
29. Shpenzime për interesat me normë efektive të interesit 50
30. Të ardhura nga komisionet 51
31. Shpenzime për komisionet 51
32. Rimarrje / (humbje) të pritshme kreditore për aktivet financiare 51
33. Shpenzime personeli 52
34. Rimarrje neto nga provizione të tjera 52
35. Shpenzime administrative 53
36. Tatimi mbi fitimin 53
37. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara 54
38. Transaksionet me palët e lidhura 56
39. Ngjarjet pas dates së raportimit 57
40. Analiza e aktiveve dhe detyrimeve sipas maturitetit 58
41. Administrimi i rrezikut financiar 59-105

Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUIS: K61911012I
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower,6th floor
1001,Tirana,Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Banka OTP Albania sh.a

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka OTP Albania sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor 2023 të Banka OTP Albania sh.a

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2023, përgatitur ne përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2023 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë proçedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë proçedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Bankës të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka OTP Albania sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojme gjatë auditimit.

Ernst & Young – Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

13 qershor 2024
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2023

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktivet			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	20,547,198	17,779,996
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	10	14,213,819	14,954,227
Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare	11	894,030	627,752
Investime në letra me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	12	27,713,277	32,545,181
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	12.1	10,484,224	3,151,358
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	13	93,413,612	99,925,011
Qiratë financiare të arkëtueshme	13.1	1,540,095	1,232,223
Aktive të tjera	14	1,685,703	680,369
Aktive afatgjata materiale	15	4,967,234	3,520,252
Aktive me të drejtë përdorimi	16	1,323,193	1,224,401
Aktive afatgjata jomateriale	17	392,315	495,304
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	18	113,488	187,412
Aktive tatimore të shtyra, neto	25	49,772	310,265
Totali i aktiveve		**177,337,960**	**176,633,751**
Detyrimet			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	19	2,166,715	8,636,055
Detyrime ndaj klientëve	20	148,343,661	147,376,492
Detyrime të qirasë	21	1,202,301	1,214,070
Borxhi i varur	23	775,526	-
Detyrime të tjera	22	2,819,846	1,874,217
Provizione për detyrime dhe të tjera	24	303,292	433,910
Totali i detyrimeve		**155,611,341**	**159,534,744**
Kapitali			
Kapitali aksionar	26	6,740,900	6,740,900
Primi i lidhur me aksionin		1,750	1,750
Rezerva	27	6,520,246	4,863,651
Fitim i pashpërndarë		8,463,723	5,492,706
Totali i kapitalit		**21,726,619**	**17,099,007**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**177,337,960**	**176,633,751**

Pasqyrat e pozicionit financiar duhen lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në 105, të cilat janë pjesë perberese e ketyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtuesit e Bankës më 30 Maj 2024 dhe janë nënshkruar në emër të saj nga:

Bledar Shella
Drejtor Ekzekutiv

Banka OTP Albania sh.a. Drejtoria e Përgjithshme

Attila Kovacs
Drejtor i Divizionit të Financës

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga interesat me normë efektive të interesit	**28**	8,945,985	4,855,233
Shpenzime për interesat me normë efektive të interesit	**29**	(1,051,413)	(547,232)
Marzhi neto nga interesat dhe të ardhurat e ngjashme		**7,894,572**	**4,308,001**
Të ardhura nga komisionet	**30**	1,535,037	1,138,551
Shpenzime nga komisionet	**31**	(565,836)	(415,400)
Të ardhura neto nga komisionet		**969,201**	**723,151**
Rimarrje /(humbje) të pritshme të kredisë për aktivet financiare	**32**	**229,058**	**1,065,148**
Fitim nga kurset e këmbimit, neto		333,488	167,387
Humbja neto nga shitja e aktiveve VDATGj	**12**	(38,152)	-
Humbja neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(51,910)	(32,901)
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të riposeduara		40,801	13,152
Fitim/(humbje) të tjera, neto		(8,862)	2,499
Të ardhura të tjera, neto		**275,365**	**150,137**
Shpenzimet personeli	**33**	(1,840,431)	(1,130,277)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	**15**	(196,368)	(106,578)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	**17**	(155,781)	(79,286)
Zhvlerësimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	**16**	(325,286)	(177,934)
Shpenzime administrative	**35**	(2,830,885)	(1,062,512)
Rimarrje neto nga provizione të tjera	**34**	67,605	69,033
Totali i shpenzimeve		**(5,281,146)**	**(2,487,554)**
			-
Fitimi para tatimit		**4,087,050**	**3,758,883**
Tatimi mbi fitimin	**36**	(697,678)	(626,039)
Të ardhura /(shpenzime) tatimore te shtyra	**25**	(9,831)	18,550
Fitimi i vitit, neto		**3,379,541**	**3,151,394**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që mund të riklasifikohen në periudhat e ardhshme në fitim ose humbje:			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të mbajtura me VDATGj, neto nga tatimi		1,248,070	(2,102,127)
Të ardhura/(humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimet		**1,248,070**	**(2,102,127)**
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimi		**4,627,611**	**1,049,267**

Pasqyrat e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 105, të cilat janë pjesë përbërese e ketyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullatore	Rezerva për vlerën e drejtë	Rezerva e bashkimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2022	**6,740,900**	**1,750**	**1,197,808**	**914,782**	**-**	**2,436,928**	**11,292,168**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse							
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	3,151,394	**3,151,394**
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj	-	-	-	(2,102,127)	-	-	**(2,102,127)**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin				**(2,102,127)**		**3,151,394**	**1,049,267**
Rezerva e bashkimit nga blerja e Alpha Bank Albania (Shënimi 8.1)	-	-	-	-	4,757,573	-	**4,757,573**
Alokimi i fitimit të pashpërndarë në rezervë ligjore (Shënimi 27 (i))	-	-	95,615	-	-	(95,615)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	**6,740,900**	**1,750**	**1,293,423**	**(1,187,345)**	**4,757,573**	**5,492,707**	**17,099,008**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse							
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	3,379,541	**3,379,541**
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj	-	-	-	1,248,070	-	-	**1,248,070**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin				**1,248,070**		**3,379,541**	**4,627,611**
Alokimi i fitimit të pashpërndarë në rezervë ligjore (Shënimi 27 (i))	-	-	408,526	-	-	(408,526)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	**6,740,900**	**1,750**	**1,701,948**	**60,725**	**4,757,573**	**8,463,723**	**21,726,619**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 105, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti operativ:			
Fitimi para tatimit		4,087,050	3,758,883
Rregullime për të kuadruar aktivet neto me flukseve monetare nga veprimtaritë operative:			
Zhvlerësimi	**15**	196,368	106,578
Amortizimi	**17**	155,781	79,286
Zhvlerësimi i aktiveve me të drejë përdorimi	**16**	325,286	177,934
Zhvlerësimi/(rrimarrje) e aktiveve financiare	**32**	(229,058)	(1,065,148)
Rënie në vlerë mbi aktivet e marra në rrugë ligjore	**18**	43,829	768
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		51,910	32,901
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të mara në rrugë ligjore		(40,801)	(13,152)
Efekte të tjera rivlerësimi		423,423	(195,656)
Të ardhura nga interesat	**28**	(8,945,985)	(4,855,233)
Shpenzime nga interesat	**29**	1,051,413	547,232
Fitimi operativ para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		**(2,880,784)**	**(1,425,607)**
Ndryshim në aktivet dhe pasivet operative:			
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore		740,408	(36,058)
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare		(266,278)	14,239,947
Hua dhe paradhënie për klientët		6,396,527	(3,796,542)
Aktive të tjera		(1,005,334)	(475,804)
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave		(402,376)	(455,509)
Detyrime ndaj klientëve		967,169	3,228,690
Detyrime të tjera		945,629	(347,040)
Të ardhura nga shitja e kolateraleve të riposeduara		66,359	15,637
Interesi i arkëtuar		8,936,473	4,710,174
Interesi i paguar		(1,334,873)	(605,120)
Tatim fitimi i paguar		(690,000)	(476,590)
Flukset neto te mjeteve monetare gjeneruar nga aktivitetet operative		**11,472,920**	**14,576,178**
Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti investuese:			
Blerje e aktiveve financiare me VDATGj		(7,560,897)	(2,725,000)
Të ardhura nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe riblerjet e letrave me vlerë të mbajtura me VDATGj		6,975,204	2,903,200
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale		(31,398)	(8,725)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(1,762,730)	(2,699,536)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		99,113	32,706
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre të marra nga bashkimi (8.1)		-	4,408,467
Flukset neto te mjeteve monetare të gjeneruar / (përdorur) për aktivitetin investuese		**(2,280,708)**	**1,911,112**
Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti financuese:			
Borxhi i varur		775,526	-
Pagesat e principalit të detyrimeve të qirasë	**21**	(352,428)	(207,671)
Shlyerje e huamarrjeve		(6,066,964)	(8,335,123)
Fluksi neto te mjeteve monetare përdorur për aktivitetin financuese		**(5,643,866)**	**(8,542,794)**
Rritje neto të mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre		**3,548,346**	**7,944,496**
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit		**17,779,996**	**9,382,469**
Efekti neto nga ndryshimi i kursit të mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre		(781,144)	453,030
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	**9**	**20,547,198**	**17,779,996**

Pasqyra e fluksi të mjeteve monetare *duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 105, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare*

1. Të përgjithshme

Banka OTP Albania Sh.a, ("Banka") është një institucion financiar shqiptar i themeluar më 12 dhjetor 2003 sipas ligjit shqiptar mbi shoqëritë tregtare dhe u licensua nga Banka e Shqipërisë ("Banka Qendrore") më 16 shkurt 2004 (vendimi nr.17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i muajit Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr. 8269, i dhjetorit 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë". Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004. OTP Bank NYRT është mëma përfundimtare e Grupit.

Në datën 1 dhjetor 2022, Banka dhe "Alpha Bank Albania" sh.a." (e njohur edhe si "ABA") u bashkuan ligjërisht duke inkorporuar aktivet dhe detyrimet me Bankën. Përpara bashkimit, Banka dhe ABA ishin nën kontrollin e përbashkët të OTP Bank NYRT duke qenë i njëjti dhe aksioneri i vetëm që nga 18 korrik 2022 kur OTP Bank NYRT bleu ABA-n. Banka dhe aksioneri i ABA miratuan termat dhe kushtet e bashkimit më 1 dhjetor 2022 pas miratimit paraprak rregullator të marrë më 23 nëntor 2022.

Më 31 dhjetor 2023, Banka ka operuar përmes zyrave qëndrore që ndodhen në Tiranë dhe 49 degëve të saj (2022: 61 degë). Banka ushtron aktivitetin vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2023 Banka kishte 748 punonjës (31 dhjetor 2022: 819 punonjës). Zyra e regjistruar e Bankës është pranë Kullat Binjake, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla 1, Kati 9, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2023, Këshilli Mbikqyrës dhe Komiteti i Kontrollit të Bankës përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Bordi Mbikqyrës	Gabor Kolics	Kryetar
	Ilir Ciko	Anëtar
	Stavri Pashko	Anëtar
	Örs Levente Szilágyi	Anëtar
	Orsolya Csilla Kovács	Anëtar
	Armando Duka	Anëtar
	Janos Veres	Anëtar
Komiteti i Auditimit	Stavri Pashko	Kryetar
	Jitka Pantůčková	Anëtar
	Zoltan Molnar	Anëtar

2. Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGj") të aktiveve financiare që janë matur me vlerën e drejtë dhe kolateraleve të riposeduara të cilat maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Pasqyrat financiare paraqiten në lekë ("Lek") dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur tregohet ndryshe.Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e vazhdimësisë, pasi drejtimi është i kënaqur që Banka ka burime të mjaftueshme për të vazhduar si vijimësi për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, menaxhimi ka marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni duke përfshirë parashikimet e përfitueshmërisë, kërkesat rregullatore për kapital dhe nevojat për financim. Vlerësimi përfshin gjithashtu shqyrtimin e skenarëve të arsyeshëm të mundshëm ekonomikë dhe ndikimet e tyre të mundshme në rentabilitetin, kapitalin dhe likuiditetin e Bankës dhe shoqërisë mëmë të saj.

2.1 Të dhëna krahasuese

Një riklasifikim i caktuar është bërë me qëllim që të sigurohet një prezantim dhe shpalosje më e mirë informacioni shpjegues në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022. Më konkretisht: "Ulje në vlerën neto të realizueshme" e Aktive të riposeduara dhe "Provizioni për çështjet gjyqësore dhe rreziqe të tjera operacionale, neto" prej 69,033 mijë lekë u paraqit nën "Të ardhura/shpenzime të tjera neto" në pasqyrën e fitim/humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për fundin e vitit 31 dhjetor 2022, dhe për të dyja periudhat 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 këto janë paraqitur në një linjë të veçantë "Rimarrje neto nga provizione të tjera" (Shënimit 34).

3. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

4. Paraqitja e pasqyrave financiare

Banka paraqet pasqyrën e saj të pozicionit financiar sipas likuiditetit bazuar në synimin dhe aftësinë e perceptuar të Bankës për të rikuperuar/shlyer pjesën më të madhe të aktiveve/detyrimeve të zërit përkatës të pasqyrës financiare. Një analizë në lidhje me rikuperimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (aktuale) dhe më shumë se 12 muajve pas datës së raportimit (jo aktuale) është paraqitur në Shënimin 40.

5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese

Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara.

Banka nuk ka miratuar më herët ndonjë standard të ri, interpretim apo ndryshim që është nxjerrë por nuk është ende efektiv në periudhën raportuese korrente. Ndryshime dhe interpretime të tjera zbatohen për herë të parë në vitin 2023, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës, të përshkruara shkurtimisht më poshtë:

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikave të SNRF 2: Shpalosja e politikave kontabël (Amendime).** Amendimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2023. Amendimet ofrojnë udhëzime për zbatimin e gjykimeve të materialitetit në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Në veçanti, amendimet në SNK 1 zëvendësojnë kërkesën për të shpalosur politikat kontabël 'të rëndësishme' me një kërkesë për të shpalosur politikat kontabël 'materiale'. Gjithashtu, udhëzues dhe shembuj ilustrues shtohen në Deklarimin e Praktikës për të ndihmuar në zbatimin e konceptit të materialitetit kur bëhen gjykime në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Amendimet kanë pasur ndikim në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël të Bankës, por jo në matjen, njohjen ose paraqitjen e ndonjë zëri në pasqyrat financiare të Bankës.

- **SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Amendime).** Amendimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe. Amendimet prezantojnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuara si shuma monetare në pasqyrat financiare që i nënshtrohen pasigurisë në matje, nëse ato nuk rezultojnë nga një korrigjim i gabimit të periudhës së mëparshme. Gjithashtu, amendimet në vlerësimet kontabël qartësojnë se cilat janë ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe si vlerësohen këto nga ndryshimet në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve. Amendimet nuk kishin ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Amendime).** Amendimi është efektiv per periudhën raportuese filluar në ose pas janarit 2023. Amendimi ngushton fushëveprimin dhe jep qartësi të mëtejshme mbi përjashtimin e njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikon se si kompanitë duhet të llogarisin tatimin e shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, të tilla si qiratë dhe detyrimet e dekomisionimit. Amendimet qartësojnë se kur pagesat që shlyejnë një detyrim janë të zbritshme për qëllime tatimore, është çështje gjykimi, duke pasur parasysh ligjin tatimor në fuqi, nëse këto zbritje i atribuohen për qëllime tatimore detyrimit ose përbërësit të aktivit përkatës. Sipas amendimeve, përjashtimi i njohjes fillestare nuk zbatohet për transaksionet që, në njohjen fillestare, krijojnë diferenca të përkohëshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme. Ai zbatohet vetëm nëse njohja e një aktivi me qira dhe pasivi i qirasë (ose pasivi i dekomisionimit dhe komponenti i aktivit të dekomisionimit) sjellin diferenca të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme që nuk janë të barabarta. Amendimet nuk kishin ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Reforma Tatimore Ndërkombëtare - Rregulla Modeli i Shtyllës së Dytë (Amendimet).** Amendimet hyjnë në fuqi menjëherë pas lëshimit, por disa kërkesa për paraqitjen e informacionit hyjnë në fuqi më vonë. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik publikoi rregullat e modelit të Shtyllës së Dytë në dhjetor 2021 për të siguruar që kompanitë e mëdha shumëkombëshe do t'i nënshtrohen një norme tatimore minimale prej 15%. Më 23 maj 2023, BSNK publikoi Reformën Ndërkombëtare Tatimore - Rregullat Modeli të Shtyllës së Dytë – Ndryshimet në SNK 12. Amendimet paraqesin një përjashtim të përkohshëm të detyrueshëm në kontabilitetin për tatimet e shtyra që rrjedhin nga zbatimi juridiksional i rregullave të modelit të Shtyllës së Dytë dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese për subjektet e prekura mbi ekspozimin e mundshëm ndaj taksave mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë. Amendimet kërkojnë, për periudhat në të cilat legjislacioni i Shtyllës së Dytë është miratuar (në thelb), por ende jo në fuqi, dhënie informacionesh shpjeguese të informacionit të njohur ose të arsyeshëm të vlerësuar që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ekspozimin e njësisë ekonomike që rrjedh nga tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë. Dhënia e informacioneve shpjeguese për shpenzimet aktuale tatimore lidhur me tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me periudhat përpara se legjislacioni të hyjë në fuqi kërkohen për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023, por nuk kërkohen për asnjë periudhë të ndërmjetme që përfundon më ose para datës 31 dhjetor 2023. Banka ka vlrësuar se nuk do të jetë subjekt i tatimeve të Shtyllës së Dytë kur legjislacioni të hyjë në fuqi pasi norma e saj tatimore efektive është 15%. Prandaj, duke qenë se nuk kërkohen dhënie informacionesh shpjeguese për Shtyllën e Dytë, amendimet nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të bankave më 31 dhjetor 2023.

5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese (vazhdim)

Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara (vazhdim)

- **SNFR 17: Kontratat e sigurimit**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023. Ky është një standard i ri gjithëpërfshirës i kontabilitetit për kontratat e sigurimit, që mbulon njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit të lëshuara, si dhe për garancitë dhe instrumentet financiare të caktuara me kontrata pjesëmarrjeje diskrecionale. Përveç përjashtimeve të përshkruara më poshtë, Banka nuk ka identifikuar kontrata që rezultojnë në transferimin e rrezikut të rëndësishëm të sigurimit, dhe për këtë arsye ka arritur në përfundimin se SNRF 17 nuk ka një ndikim material në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023.

Si pjesë e këtij përcaktimi, Banka vlerësoi kontratat e huasë që plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi, por kufizojnë kompensimin për ngjarjet e siguruara në shumën që kërkohet ndryshe për të shlyer detyrimin e mbajtësit të policës së krijuar nga kontrata, p.sh. një hua me falje deri ne vdekje hamarrësi, ekziston një zgjedhje për të zbatuar ose SNRF 9 ose SNRF 17 për kontrata të tilla. Kjo zgjedhje bëhet në nivel portofoli dhe është e parevokueshme. Banka ka bërë një zgjedhje të parevokueshme për të zbatuar SNRF 9 për çdo portofol të këtyre produkteve.

6. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare nga Banka. Për më tepër, Banka miratoi dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2) nga 1 janari 2023. Ndryshimet kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël 'materiale' dhe 'jomateriale'. Amendimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël dhe nuk ndikuan në mënyrë thelbësore në informacionin e politikave kontabël.

(a) Transferimi i interesit të kontrollit në njësitë ekonomike nën kontroll të përbashkët

Bashkimi me Alpha Bank i përshkruar në detaje në shënimin 8.1 është një kombinim biznesi i njësive ekonomike nën kontroll të përbashkët jashtë objektit të SNRF 3 Kombinimet e Biznesit. Në mungesë të udhëzimeve specifike nga SNRF, njësitë ekonomike të përfshira në transaksionet e kontrollit të përbashkët u kërkohet të zhvillojnë një politikë kontabël të përshtatshme, që do të zbatohet vazhdimisht, duke përdorur hierarkinë e përshkruar në SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimin Kontabël dhe Gabimet.

Drejtimi ka zgjedhur të llogarisë transfertat e kontrollit të interesit në subjektet që janë nën kontrollin e aksionerit që kontrollon Bankën duke përdorur metodën e grupimit të interesit. Në zbatimin e kësaj metode, aktivet dhe detyrimet e blera njihen me vlerat kontabël (vlerat e librave) të njohura më parë në pasqyrat financiare individuale të njësisë ekonomike të blerë dhe aktivet neto korresponduese njihen në zërat e kapitalit neto si rezervë e bashkimit.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë rezultatet e kombinimit të njësive ekonomike duke përfshirë njësinë ekonomike të bashkuar në datën e kombinimit ligjor. Kjo politikë është aplikuar në mënyrë konsistente dhe do të zbatohet për të gjitha transaksionet e ardhshme të ngjashme.

(b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek shqipëtar ("Lek"), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës.

(c) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin e datës së raportimit. Fitimi ose Humbja në valutë të huaj nga instrumentet financiare me kosto të amortizuar, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
USD	93.94	107.05
EUR	103.88	114.23

6. Përmbledhje e politikave të kontabilitetit (vazhdim)

(d) Interesi

Metoda e normës efektive të interesit

Të ardhurat nga interesi regjistrohen duke përdorur metodën e interesit efektiv (NEI) për të gjithë instrumentat financiarë të matur me koston e amortizuar, duke përfshirë qiranë financiare. Të ardhurat nga interesi nga instrumentat e borxhit të mbajtur me VDATGj gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën NEI. Shpenzimet e interesit llogariten gjithashtu duke përdorur metodën NEI për të gjitha detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. NEI është norma që pikërisht aktualizon flukset e ardhshme të parave përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, në një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël neto të aktivit financiar.

NEI (dhe për këtë arsye, kostoja e amortizuar e aktivit) llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim për blerjen, tarifat dhe kostot që janë pjesë përbërëse e NEI. Banka njeh të ardhurat nga interesi duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Prandaj, Banka njeh efektin e normave të interesit potencialisht të ndryshme të ngarkuara në faza të ndryshme dhe karakteristikave të tjera të ciklit të jetës së produktit (përfshirë parapagimet, interesat e penaliteteve dhe gjobat).

Nëse pritshmëritë e flukseve monetare të aktiveve ose detyrimeve financiare me normë fikse rishikohen për arsye të tjera përveç rrezikut të kredisë, atëherë ndryshimet në flukset monetare të ardhshme kontraktuale skontohen me NEI origjinale me një rregullim në vijim në vlerën kontabël. Diferenca nga vlera kontabël e mëparshme regjistrohet si një sistemim pozitiv ose negativ në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar në bilanc me një rritje ose ulje përkatëse në të ardhurat/shpenzimet nga interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Për instrumentet financiare me normë të ndryshueshme interesi, rivlerësimi periodik i flukseve monetare për të reflektuar lëvizjet në normat e interesit të tregut ndryshojnë gjithashtu normën efektive të interesit, por kur instrumentet financiarë u njohën fillimisht në një shumë të barabartë me principalin, rivlerësimi i pagesave të ardhshme të interesit nuk ndikon ndjeshëm vlerën kontabël të aktivit ose e detyrimit.

Interesa dhe të ardhura/shpenzime të ngjashme

Të ardhurat nga veprimtaritë bankare, duke përfshirë të ardhurat nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve, të ardhurat nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, njihen në fitim ose humbje duke zbatuar NEI në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, përveç aktiveve të zhvlerësuara.

Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Standarti 3' (shiko shënim 6 (j) (vi) A), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke zbatuar NEI në koston e amortizuar neto të aktivit financiar. Nëse mjetet financiare trajtohen (siç është përshkruar ne Shënimin 41.b) dhe nuk kanë zhvlerësim Banka kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto.

Për aktivet financiare të zhvlerësuara që në blerje ose në krijim (POCI) (sic është përshkruar në shënimin 41.b), Banka llogarit të ardhura nga interesi duke llogaritur normën efektive të interesit të rregulluar dhe duke zbatuar atë normë në koston e amortizuar të aktivit financiar. Norma Efektive e Interesit e rregulluar është norma e interesit që, në njohjen fillestare, aktualizon flukset monetare të ardhshme të vlerësuara (duke përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të aktiveve të zhvlerësuara që në blerje ose në krijim (POCI).

Banka shpalos interesin e paguar për këto aktive financiare si shpenzim interesi, me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë në shënimin 28.

Të ardhurat nga interesi nga qiraja financiare njihen gjatë afatit të qirasë duke përdorur metodën e investimit neto (para tatimit), e cila pasqyron një normë konstante periodike kthimi / duke aplikuar normën e nënkuptuar në qira për (i) vlerën kontabël bruto të qirasë të arkëtueshmet në fazën 1 dhe 2 dhe (ii) vlerën kontabël neto të llogarive të arkëtueshme të qirasë në fazën 3 të modelit HPK.

Të ardhurat nga qiratë regjistrohen brenda të ardhurave nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv në fitim ose humbje.

6. Përmbledhje e politikave të kontabilitetit (vazhdim)

(e) Tarifa dhe komisione

Banka fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e ndryshme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në një vlerë që pasqyron shumën për të cilën Banka pret të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve. Detyrimet e ekzekutimit, si dhe koha e përmbushjes së tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kontratat e të ardhurave të Bankës nuk përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, siç shpjegohet më tej në Shënimet A dhe B më poshtë.
Kur Banka ofron një shërbim për klientët e saj, shuma faturohet dhe në përgjithësi duhet të paguhet menjëherë me kënaqësinë e një shërbimi të ofruar në një moment kohor ose në fund të periudhës së kontratës për një shërbim ofruar me kalimin e kohës.

Banka në përgjithësi ka arritur në përfundimin se ajo është kryesore në marrëveshjet e saj të të ardhurave, sepse zakonisht kontrollon shërbimet përpara se t'i transferojë ato te klienti.

A. Të ardhurat nga tarifat e fituara nga shërbimet që ofrohen gjatë një periudhe të caktuar kohore

Tarifat dhe komisionet e fituara nga ofrimi i shërbimeve gjatë një periudhe kohore janë grumbulluar gjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhurat nga komisionet, duke përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, tarifat e menaxhimit të investimeve dhe tarifat e vendosjes.

B. Të ardhurat nga tarifat nga ofrimi i shërbimeve financiare dhe të fituara për ekzekutimin e një akti të rëndësishëm

Tarifat dhe komisionet që dalin nga negocimi ose pjesëmarrja në negocimin e një transaksioni me një palë të tretë, siç janë tarifat e tjera dhe shpenzimet e komisioneve që lidhen kryesisht me tarifat e transaksionit dhe shërbimit, njihen pas përfundimit të transaksionit bazë. Tarifat ose komponentët e tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas plotësimit të kritereve përkatëse.

C. Të ardhurat nga tarifat që përbëjnë një pjesë integrale të instrumentit financiar korrespondues

Tarifat që Banka konsideron të jenë pjesë përbërëse e instrumentave financiarë përkatëse përfshijnë: tarifat e marrjes së huasë, pagesat e angazhimit të kredisë për huatë që ka gjasa të tërhiqen dhe tarifat e tjera të lidhura me kredinë. Njohja e këtyre tarifave (së bashku me kostot shtesë) përbëjnë një pjesë integrale të instrumentave financiarë përkatëse dhe njihen si të ardhura nga interesi nëpërmjet një rregullimi në NEI.

Financimet janë krijuar duke përdorur një seri instrumentash si p.sh depozita, detyrime të tjera të evidentuara në letra dhe aksione. Kjo përforcon fleksibilitetin e financimit, kufizon pavarësinë mbi çdo burim fondesh si dhe në përgjithësi ul kostot e financimit. Banka bën përpjekjet e saj për të mbajtur një tepricë mes vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit përmes përdorimit të detyrimeve me maturitet të ndryshëm. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financimin e kërkuar për të arritur objektivat e biznesit të përcaktuar në strategjinë e përgjithshme të bankës.

Tabela e mëposhtme tregon flukset e parasë nga detyrimet dhe aktivet e bankës, të skontuara, sipas periudhave të ripagimit më të hershme të mundshme.
Flukset e pritshme të parasë së Bankës mund të ndryshojnë ndjeshëm nga kjo analizë. Për shembull, depozitat pa afat nga klientët pritet të mbajnë një bilanc të qëndrueshëm ose në rritje.

Për më tepër banka mban një portofol të aktiveve likuide si pjesë e strategjisë së administrimit të rrezikut të likuiditetit.

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka mund të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare kur ato janë në afat ose mund të shkaktohen humbje financiare si rezultat i shitjes së aktiveve me kushte të pafavorshme për shkak të menaxhimit joadekuat të likuiditetit, ose kostove shtesë për shkak të fondeve shtesë të huamarrjes, ose të ardhura të humbura për shkak të mbajtjes së likuiditetit të tepërt.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit të Bankës për monedhat e huaja menaxhohet në nivel të Grupit OTP brenda kuadrit të konceptit të grupit të likuiditetit. Sipas tij, një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve të likuiditetit mbulohet nga një grup i përbashkët likuiditeti - i menaxhuar nga OTP Bank - që siguron akses të menjëhershëm për të gjithë anëtarët e grupit, ndërsa filialet duhet të mbajnë rezervën e tyre të likuiditetit për rreziqet që janë të vështira për t'u matur dhe menaxhohen nga selia. Në këtë kuadër rreziku i likuiditetit lidhur me pozicionet në monedhën shqiptare (LEK) nuk administrohet nga OTP Group. Banka duhet të menaxhojë pozicionet e likuiditetit në lekë dhe rrezikun përkatës në nivel lokal.
Në fushën e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, Banka zbaton metodologjitë e mëposhtme në përputhje me kërkesat rregullatore dhe të kompanisë mëmë, e cila mundëson matjen e pozicionit aktual dhe të ardhshëm të likuiditetit. Banka menaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut pjesërisht nga administrimi dhe analiza e pozicioneve të likuiditetit, pjesërisht duke përcaktuar kufijtë e brendshëm për ekspozimet ndaj rrezikut.

Banka duhet së pari të jetë në përputhje me rregulloren vendore të parashikuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Rregulloret e likuiditetit të nxjerra nga Banka e Shqipërisë janë:

- Rregullorja nr. 71 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", datë 14.10.2009.
- Rregullorja nr. 27, "Për raportin e mbulimit të likuiditetit", hyrë në fuqi më 1.3.2020.
- Vendimi nr. 70, datë 2.12.2020 "Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave"; ka hyrë në fuqi në janar 2023.

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 71 Banka është e detyruar të respektojë raportet e likuiditetit (aktive likuide/detyrime afatshkurtra) si më poshtë

- **Raporti i likuiditetit total:**
  (të gjithë artikujt në monedhë)
  Aktivet likuide / Detyrimet afatshkurtra ≥ 20%
- **Raporti i likuiditetit në monedhën vendase:**
  (zëra në lekë)
  Aktivet likuide / Detyrimet afatshkurtra ≥ 15%
- **Raportet e likuiditetit të monedhave të tjera:**
  (zëra të tjerë në valutë të huaj)
  Aktivet likuide / Detyrimet afatshkurtra ≥ 20%

Banka ka qenë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2023. Raporti i likuiditetit total është dhjetor 2023 është 35.2 % (dhjetor 2022: 36.90%).

Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (RML) brenda 1 muaji raportohet çdo muaj sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për RML.

Krahasuar me kufirin rregullator lokal (100%) për RML totale, një objektiv i brendshëm më i rreptë është përcaktuar në nivelin 110%. Në rast të shkeljes së këtij kufiri, menaxhimi aktiv bëhet i nevojshëm për të shmangur shkeljen e kufirit rregullator. Ndërkohë për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme kufiri rregullator vendor nuk është më i ulët se 80%.

Banka ka qenë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2023**.** *Raporti i mbulimit të likuiditetit total (RML) në dhjetor 2023 është 303.2% (dhjetor 2022: 198.5%) shumë mbi kufirin rregullator jo më të ulët se 100%. Raporti përkatës RML në valutë të huaj menaxhohet me grupin e likuiditetit te OTP Group.*

Sipas rregullores RML të Bankës së Shqipërisë një kufi i valutave totale është përcaktuar të paktën 100% dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme të paktën 80% është në fuqi nga 1 mars 2020. Sipas rregullores se Bankës së Shqipërisë për raportin e detyrueshëm të raportit të qëndrueshmëm të financimit neto (NSFR) raportohet në baza tremujore.

Krahasuar me kufirin rregullator lokal (100%) për NSFR-në totale, një objektiv i brendshëm më i rreptë përcaktohet në nivelin 105%.

Banka ka qënë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2023. *Raporti Total Neto i Financimit të qëndrueshëm (NSFR) në dhjetor 2023 është 164% shumë mbi kufirin rregullator jo më të ulët se 100%.*

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për raportin neto të financimit të stabilitetit (NSFR), një kufi i valutave totale është përcaktuar të paktën 100% dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme të paktën 70%-100% është në fuqi nga 1 janar 2023. Zbatimi i monedhës së rëndësishme RNFS është gradualisht si më poshtë:

MONEDHA TOTALE E RËNDËSISHME NSFR

- 1 janar 2023 70%
- 1 janar 2024 80%
- 1 janar 2025 100%

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas maturimeve kontraktuale më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Aktive							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	-	-	-	-	-	**20,547,198**
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	14,213,819	-	-	-	-	-	**14,213,819**
Hua dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare	33,032	218,878	590,052	52,068	-	-	**894,030**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	849,264	1,029,434	1,229,981	3,685,333	14,252,269	6,666,996	**27,713,277**
Investime në letra me vlerë me kosto të amotizuar			1,752,091	1,852,578	6,879,555		**10,484,224**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	3,767,097	2,792,821	4,816,265	9,875,103	23,800,742	48,361,584	**93,413,612**
Qiratë financiare të arkëtueshme	1,308	3,033	6,379	43,591	1,438,273	47,511	**1,540,095**
Aktive te tjera	1,121,065	-	-	564,638	-	-	**1,685,703**
Totali i aktiveve	**40,532,783**	**4,044,166**	**8,394,768**	**16,073,311**	**46,370,839**	**55,076,091**	**170,491,958**
Detyrime							
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave	378,902	519	-	1,688,275	99,019		**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	82,421,715	5,034,866	8,033,010	31,021,372	19,063,143	2,769,555	**148,343,661**
Qira financiare	26,005	188	332	35,137	347,437	793,202	**1,202,301**
Detyrime të tjera	366,764	1,744,497	-	708,585	-	-	**2,819,846**
Borxhi i varur	-	-	-	-	775,526	-	**775,526**
Total i detyrimeve	**83,193,386**	**6,780,070**	**8,033,342**	**33,453,369**	**20,285,125**	**3,562,757**	**155,308,049**
Ekspozimi	**(42,660,603)**	**(2,735,904)**	**361,426**	**(17,380,058)**	**26,085,714**	**51,513,334**	**15,183,909**
Efekti kumulativ	**(42,660,603)**	**(45,396,507)**	**(45,035,081)**	**(62,415,139)**	**(36,329,425)**	**15,183,909**	**-**

Drejtimi beson se pavarësisht se një pjesë e konsiderueshme e llogarive të klientëve janë depozita pa afat, diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve, dhe përvoja e kaluar e bankës do të tregonte se këto llogari klientësh ofrojnë një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm financimi për Bankën.

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas maturimeve kontraktuale më 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

Aktive	**Deri në 1 muaj**	**1 deri në 3 muaj**	**3 deri në 6 muaj**	**6 deri në 12 muaj**	**1 vit deri në 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Totali**
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	17,779,996	-	-	-	-	-	**17,779,996**
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	14,954,227	-	-	-	-	-	**14,954,227**
Hua dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare	627,752	-	-	-	-	-	**627,752**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	713	1,327,708	608,946	3,123,297	20,683,191	6,801,326	**32,545,181**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	-	-	-	1,748,626	1,402,732	-	**3,151,358**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	5,588,451	4,964,818	8,260,996	7,824,068	24,103,646	49,183,032	**99,925,011**
Qiratë financiare të arkëtueshme	2,693	2,116	7,906	65,869	1,153,639	-	**1,232,223**
Aktive te tjera	523,686	-	-	156,683	-	-	**680,389**
Totali i aktiveve	**39,477,518**	**6,294,642**	**8,877,848**	**12,918,543**	**47,343,208**	**55,984,358**	**170,896,117**
Detyrime							
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave	1,050,379	5,593,628	953,619	58,577	622,264	357,588	**8,636,055**
Detyrime ndaj klientëve	88,003,560	6,899,297	10,368,143	24,728,073	14,919,652	2,457,767	**147,376,492**
Qira financiare	-	15,328	1,059	5,863	239,437	952,383	**1,214,070**
Detyrime te tjera	10,115	1,460,886	-	403,216	-	-	**1,874,217**
Totali i detyrimeve	**89,064,054**	**13,969,139**	**11,322,821**	**25,195,729**	**15,781,353**	**3,767,738**	**159,100,834**
Ekspozimi	**(49,586,536)**	**(7,674,497)**	**(2,444,973)**	**(12,277,186)**	**31,561,855**	**52,216,620**	**11,795,283**
Efekti kumulativ	**(49,586,536)**	**(57,261,033)**	**(59,706,006)**	**(71,983,192)**	**(40,421,337)**	**11,795,283**	**-**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si norma e interesit, normat e këmbimit valutor dhe diferencat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të debitorit / emetuesit) do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e zotërimeve të instrumentave financiarë të saj. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin e rrezikut. Strategjia e Bankës për menaxhimin e rrezikut për librin e saj bankar është e ndryshme për secilën nga kategoritë e mëposhtme të rrezikut të tregut dhe është përcaktuar në nënseksionet vijuese të këtyre pasqyrave financiare, si më poshtë:

Administrimi i rrezikut të tregut

Banka e ndan ekspozimin e saj ndaj rrezikut të tregut midis portofolit tregtar dhe atij jotregtar. Portofoli i tregtimit përfshin ato pozicione që rrjedhin nga transaksionet e krijimit të tregut ku Banka vepron si principal me klientët ose me tregun, së bashku me aktivet dhe detyrimet financiare që menaxhohen mbi bazën e vlerës së drejtë. Pozicioni i këmbimit valutor trajtohet si pjesë e portofolit tregtar të Bankës për qëllime të menaxhimit të rrezikut. Portofolet jotregtare lindin kryesisht nga administrimi i normave të interesit të aktiveve dhe detyrimeve bankare me pakicë dhe tregtare të njësisë ekonomike. Portofolet jotregtare gjithashtu përbëhen nga rreziqet që rrjedhin nga investimet e Bankës të mbajtura deri në maturim dhe ato të disponueshme për shitje.

Autoriteti i përgjithshëm për rrezikun e tregut i është dhënë Komitetit të Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve (KAD). KAD është përgjegjëse për zhvillimin e politikave të detajuara të menaxhimit të rrezikut dhe ndjekjen e rregullt të zbatimit të tyre. Kufijtë e rrezikut të tregut miratohen përfundimisht nga Bordi.

Në një nivel operacional, rreziku i tregut menaxhohet kryesisht nga departamenti i thesarit të Bankës, i cili është përgjegjës për të siguruar që ekspozimet e Bankës janë në përputhje me kufijtë e rrezikut të tregut të miratuar nga Bordi dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura kur është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofole të tregtueshme

Banka është e ekspozuar ndaj efektit të luhatjeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja në pozicionin e saj financiar dhe fluksit të parasë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valuta të huaja. Duke qenë se monedha në të cilën Banka paraqet pasqyrat e saj financiare është Leku Shqiptar, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizja në kurset e këmbimit midis Lekut dhe monedhave të tjera. Rreziku i monedhës është rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Në përputhje me politikën e Bankës, pozicionet llogariten nga Departamenti i Financës dhe monitorohen çdo ditë nga Departamenti i Riskut dhe përdoren strategji mbrojtëse për të siguruar që pozicionet të mbahen brenda kufijve të përcaktuar.

Kufijtë për pozicionet neto që Banka mund të mbajë në secilën monedhë kryesore, si dhe kufiri individual për çdo monedhë tjetër janë përcaktuar si më poshtë:

Në mijë Lek	EUR	USD	CAD	CHF	GBP	XAU
2023	562,500	437,500	62,500	62,500	62,500	6,250
2022	562,500	437,500	62,500	62,500	62,500	6,250

Analiza e ndjeshmërisë së monedhës më poshtë llogarit efektin e një lëvizjeje të arsyeshme të mundshme të kursit të monedhës kundrejt lekut (të gjithë variablat e tjerë janë konstantë) në pasqyrën e të ardhurave (për shkak të vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve monetare të ndjeshme ndaj monedhës) dhe kapitalit (nr. kapitali special ose instrumentet mbrojtëse që ndikojnë në ndjeshmërinë e kapitalit, kështu që efekti është i njëjtë me ndjeshmërinë e fitimit dhe humbjes). Një shumë negative në tabelë pasqyron një reduktim të mundshëm neto në pasqyrën e të ardhurave ose kapitalit, ndërsa një shumë pozitive pasqyron një rritje të mundshme neto. Një ulje ekuivalente e secilës prej valutave më poshtë kundrejt lekut do të rezultonte në një ndikim të barabartë, por të kundërt.

		31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
	Rritje/(Zvoglim) në pikët bazë	**Ndjeshmëria e fitimit para tatimit**	**Ndjeshmëria e kapitalit**	**Ndjeshmëria e fitimit para tatimit**	**Ndjeshmëria e kapitalit**
LEK	+/(-) 100	(113,806)	113,806	(184,207)	184,207
USD	+/(-) 100	39,660	(39,660)	33,358	(33,358)
EURO	+/(-) 100	405,159	(405,159)	158,510	(158,510)

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare sipas monedhave më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	Lek	EUR	USD	Të tjera	Total
Aktivet					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	3,669,484	12,100,079	2,945,930	1,831,705	**20,547,198**
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	3,976,843	9,646,408	590,568	-	**14,213,819**
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	860,998	33,032	-	-	**894,030**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	19,542,023	7,755,095	416,158	-	**27,713,276**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	9,700,796	783,428	-	-	**10,484,224**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	49,578,732	43,555,392	279,488	-	**93,413,612**
Qiratë financiare të arkëtueshme	186,287	1,353,695	113	-	**1,540,095**
Aktive të tjera	1,394,780	277,322	12,339	1,262	**1,685,703**
Aktive afatgjata materiale	4,964,802	2,432	-	-	**4,967,234**
Aktive afatgjata jomateriale	392,315	-	-	-	**392,315**
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	1,323,193	-	-	-	**1,323,193**
Aktive tatimore të shtyra, neto	49,772	-	-	-	**49,772**
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	113,488	-	-	-	**113,487**
Total i aktivit	**95,753,513**	**75,506,883**	**4,244,596**	**1,832,967**	**177,337,960**
Detyrimet					
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave	455,312	1,531,676	177,743	1,984.00	**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	69,333,272	72,998,077	4,187,201	1,825,111	**148,343,661**
Detyrime të tjera	2,558,905	387,383	(134,152)	7,711	**2,819,847**
Detyrime të qirasë	393,275	674,001	135,025	-	**1,202,301**
Boxhi i varur	-	775,526	-	-	**775,526**
Provizione të tjera	274,532	28,760	-	-	**303,292**
Totali i detyrimeve	**73,015,296**	**76,395,423**	**4,365,817**	**1,834,806**	**155,611,342**
Totali i kapitalit	**21,726,619**	-	-	-	**21,726,619**
Pozicioni Neto	**22,738,217**	**(888,540)**	**(121,221)**	**(1,839)**	**21,726,619**

41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare sipas monedhave më 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	Lek	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktivet					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4,577,466	10,749,353	553,277	1,899,900	**17,779,996**
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	3,911,156	10,430,581	612,490	-	**14,954,227**
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	616,467	11,285			**627,752**
Investime në letra me vlerë me VDATGj	23,579,397	8,510,472	455,312	-	**32,545,181**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	2,285,537	865,821	-	-	**3,151,358**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	41,711,181	55,290,579	2,923,251		**99,925,011**
Qiratë Financiare të arkëtueshme	48,141	1,183,583	499	-	**1,232,223**
Aktive të tjera	408,153	243,444	7,831	20,941	**680,369**
Aktive afatgjata materiale, neto	3,520,252	-	-	-	**3,520,252**
Aktive afatgjata jomateriale, neto	495,304	-	-	-	**495,304**
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	1,224,401	-	-	-	**1,224,401**
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	310,265				**310,265**
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	-	187,412	-	-	**187,412**
Totali i aktivit	**82,687,720**	**87,472,530**	**4,552,660**	**1,920,841**	**176,633,751**
Detyrimet					
Detyrime ndaj institucioneve financiare	647,891	7,931,252	56,903	9	**8,636,055**
Detyrime ndaj klientëve	66,274,868	74,690,811	4,558,255	1,852,558	**147,376,492**
Detyrime të tjera	488,701	1,080,714	285,966	18,836	**1,874,217**
Detyrime të qirasë	70,591	846,562	296,917	-	**1,214,070**
Detyrime tatimore të shtyra, neto	342,079	81,535	10,296	-	**433,910**
Totali i detyrimeve	**67,824,130**	**84,630,874**	**5,208,337**	**1,871,403**	**159,534,744**
Totali i kapitalit	**11,488,001**	**5,611,006**	**-**	**-**	**17,099,007**
Pozicioni Neto	**14,863,590**	**2,841,656**	**(655,677)**	**49,438**	**17,099,007**

41. Administrimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – portofoli jo i tregtueshëm

Rreziku primar ndaj të cilit janë ekspozuar portofolet jo të tregtueshme është rreziku i humbjeve nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumentave financiarë për shkak të ndryshimit në normat e interesit të tregut.

KAD përkufizon dhe rishikon politikën e përcaktimit të normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare.

Tabela në vijim tregon ndjeshmërinë ndaj një ndryshimi të arsyeshëm të mundshëm të normave të interesit (të gjitha variablat e tjerë janë konstantë) të pasqyrës së të ardhurave të Bankës. Ndjeshmëria e pasqyrës së të ardhurave është efekti i ndryshimeve të supozuara në normat e interesit në fitim ose humbje për një vit, në bazë të normës së luhatshme të aktiveve financiare dhe të detyrimeve financiare të mbajtura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022. Ndjeshmëria totale e kapitalit supozohet të jetë e njëjtë me ndjeshmërinë në fitim dhe humbje dhe bazohet në supozimin se ka zhvendosje paralele në kurbën e normave të interesit.

Administrimi i rrezikut të normës së interesit ndaj hendekut të limiteve të normave të interesit është plotësuar përmes monitorimit të luhatshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës sipas skenarëve standartë dhe të ndryshëm të normës së interesit. Skenarët standartë që janë konsideruar çdo muaj përfshijnë ndryshimin me 100 pikë në rënie ose ngritje paralele në të gjithë kurbat e normave të interesit.

Një analizë e luhatshmërisë së Bankës ndaj rritjes ose zvogëlimit të normës së interesit me 100 pikë (duke supozuar asnjë lëvizje asimetrike në kurbat e normave dhe pozicionit financiar konstant) paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor 2023	**Skenar deri në një vit**		**Skenar mbi 1 vit**	
	100 pikë rritje	**100 pikë zvogëlim**	**100 pikë rritje**	**100 pikë zvogëlim**
Efekti i vlerësuar fitim / (humbje)	173,784	(173,784)	(459,433)	459,433

31 dhjetor 2022	**Skenar Deri në një vit**		**Skenar Mbi një vit**	
	100 pikë rritje	**100 pikë zvogëlim**	**100 pikë rritje**	**100 pikë zvogëlim**
Efekti i vlerësuar fitim / (humbje)	176,558	(176,558)	(206,755)	206,755

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rendimentet mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 ishin si më poshtë:

	Norma mesatare e ponderuar e interesit (Lek)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (USD)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (EUR)	
31 dhjetor	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**
Aktivet						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	-	-	-	-	-	-
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	3.25%	2.75%	-	-	0.00%	0.00%
Hua dhe paradheniet ndaj institucinet financiare	4.17%	3.54%	-	-	7.66%	1.88%
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	5.42%	5.25%	6.12%	-	2.47%	0.00%
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar	4.66%	4.94%	-	6.12%	0.91%	0.91%
Hua dhe paradhënie klientëve (përfshirë të arkëtueshmet e qirasë financiare)	5.95%	5.77%	7.98%	4.52%	6.66%	2.56%
Detyrimet						
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	1.58%	1.52%	0.00%	0.00%	3.05%	2.89%
Detyrime ndaj klientëve	0.87%	0.90%	0.29%	0.19%	0.21%	0.07%

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i Tregut (vazhdim)

Tabela e mëposhtme ofron një analizë të analizës së riçmimit të normës së interesit të Bankës për aktivet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2023. Aktivet dhe detyrimet e Bankës përfshihen me vlerën kontabël dhe kategorizohen sipas datës së riçmimit kontraktual ose datës së maturimit.

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Vlera kontabël
Aktivet							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4,153,751	-	-	-	-	16,393,447	**20,547,198**
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,213,819	-	-	-	-	-	**14,213,819**
Hua dhe paradheniet ndaj institucinet financiare	-	222,251	585,867	52,879	-	33,033	**894,030**
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	10,307,718	7,029,948	6,896,809	3,478,802	-	-	**27,713,277**
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me KA	1,185,229	4,556,673	4,638,544	103,778	-	-	**10,484,224**
Hua për klientët, vlera neto	7,737,737	12,180,488	18,815,715	37,464,536	17,215,136	-	**93,413,612**
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	80,217	269,981	332,757	812,972	44,168	-	**1,540,095**
Totali i aktiveve	**37,678,471**	**24,259,341**	**31,269,692**	**41,912,967**	**17,259,304**	**16,426,480**	**168,806,255**
Detyrimet							
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	378,902	519	-	1,688,275	99,019	-	**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	82,421,715	5,034,866	8,033,010	31,021,372	19,063,144	2,769,554	**148,343,661**
Borxhi i varur	-	-	-	-	775,526	-	**775,526**
Totali i detyrimeve	**82,800,617**	**5,035,385**	**8,033,010**	**32,709,647**	**19,937,689**	**2,769,554**	**151,285,902**
Ekspozimi	**(45,122,146)**	**19,223,956**	**23,236,682**	**9,203,320**	**(2,678,385)**	**13,656,926**	**17,520,353**
Efekti kumulativ	**(45,122,146)**	**(25,898,190)**	**(2,661,508)**	**6,541,812**	**3,863,427**	**17,520,353**	**-**

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i Tregut (vazhdim)

Analiza e riçmimit të normës së interesit të Bankës më 31 dhjetor 2022 është si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Vlera kontabël
Aktive							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,218,658	-	-	-	-	12,561,338	**17,779,996**
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,954,227	-	-	-	-	-	**14,954,227**
Hua dhe paradhenie për institucinet financiare	-	-	616,329	-	-	11,423	**627,752**
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	8,556,867	5,637,567	5,257,501	13,093,241	-	-	**32,545,176**
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me KA	-	-	346,842	2,804,516	-	-	**3,151,358**
Hua për klientët, vlera neto	9,197,237	17,886,744	24,218,368	36,217,141	12,405,520	-	**99,925,010**
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	71,417	167,160	285,306	704,721	3,619	-	**1,232,223**
Totali Aktive	**37,998,406**	**23,691,471**	**30,724,346**	**52,819,619**	**12,409,139**	**12,572,761**	**170,215,742**
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	6,644,007	953,619	58,577	622,264	357,588	-	**8,636,055**
Detyrime ndaj klientëve	88,003,586	6,899,297	10,368,143	24,728,073	14,919,626	2,457,767	**147,376,492**
Totali Detyrime	**94,647,593**	**7,852,916**	**10,426,720**	**25,350,337**	**15,277,214**	**2,457,767**	**156,012,547**
Ekspozimi	**(56,649,187)**	**15,838,555**	**20,297,626**	**27,469,282**	**(2,868,075)**	**10,114,994**	**14,203,195**
Efekti kumulativ	**(56,649,187)**	**(40,810,632)**	**(20,513,006)**	**6,956,276**	**4,088,201**	**14,203,195**	-

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

i) Vlera e drejtë e instrumenteve financiar Kjo tabelë përfshin aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat vlera e drejtë përafrohet me vlerën kontabël. Banka ka përcaktuar se për aktivet dhe detyrimet financiare që (a) kanë një maturim afatshkurtër (më pak se tre muaj), (b) janë likuide dhe (c) janë instrumente me normë të ndryshueshme, vlerat e tyre kontabël (të cilat janë neto prej zhvlerësimi aty ku është e zbatueshme) janë një përafrim i arsyeshëm i vlerës së tyre të drejtë. Instrumente të tilla përfshijnë: paratë e gatshme dhe gjendjet me bankat qendrore; për shkak dhe detyrim nga bankat.

	31 dhjetor 2023				
Aktivet dhe Detyrimet Financiare	**Vlera kontabël**				**Vlera e drejtë**
		Niveli 1	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Aktive Financiare					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	-	20,547,198	-	**20,547,198**
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,213,819	-	14,213,819	-	**14,213,819**
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	894,030	-	-	894,030	**894,030**
Instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar	10,484,224	763,615	9,805,026	-	**10,568,641**
Aktive e tjera	1,685,703	-	-	1,685,703	**1,685,703**
Hua dhe paradhënie për klientët	93,413,612	-	-	98,450,331	**98,450,331**
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	1,540,095	-	-	1,664,865	**1,664,865**
Totali i aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**142,778,681**	**763,615**	**44,566,043**	**102,694,929**	**148,024,587**
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	2,166,715	-	2,166,715	-	**2,166,715**
Detyrime ndaj klientëve	148,343,661	-	-	145,604,558	**145,604,558**
Detyrime të tjera	2,819,846	-	-	2,819,846	**2,819,846**
Totali i detyrimeve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**153,330,222**	**-**	**2,166,715**	**148,424,404**	**150,591,119**
Zërat jashtë bilancit					
Garancitë financiare	**11,117,415**	**-**	**-**	11,117,415	**11,117,415**
Letër kredi për klientët	**550,232**	**-**	**-**	550,232	**550,232**
Angazhime të tjera	**9,502,614**	**-**	**-**	9,502,614	**9,502,614**
Totali i zërave jashtë bilancit	**21,170,261**	**-**	**-**	**21,170,261**	**21,170,261**

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

i) Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë (vazhdim)

Aktivet dhe Detyrimet Financiare	31 dhjetor 2022				
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë			
		Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Aktivet Financiare					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	**17,779,996**	-	17,779,996	-	**17,779,996**
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	**14,954,227**	-	14,954,227	-	**14,954,227**
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	**627,752**	-	-	627,752	**627,752**
Instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar	**3,151,358**	865,821	2,285,537	-	**3,151,358**
Aktive e tjera	**680,369**	-	-	680,369	**680,369**
Hua dhe paradhënie për klientët	**99,925,011**	-	-	100,577,026	**100,577,026**
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	**1,232,223**	-	-	1,368,140	**1,368,140**
Totali i aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**138,350,936**	**865,821**	**35,019,760**	**103,253,287**	**139,138,868**
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	**8,636,055**	-	8,636,055	-	**8,636,055**
Detyrime ndaj klientëve	**147,376,492**	-	-	144,940,772	**144,940,772**
Detyrime të tjera	**1,874,217**	-	-	1,874,217	**1,874,217**
Totali i detyrimeve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë	**157,886,764**	**-**	**8,636,055**	**146,814,989**	**155,451,044**
Zërat jashtë bilancit					
Garancitë financiare	**13,448,987**	**-**	**-**	13,448,987	**13,448,987**
Letër kredi për klientët	**1,363,631**	**-**	**-**	1,363,631	**1,363,631**
Angazhime të tjera	**6,675,628**	**-**	**-**	6,675,628	**6,675,628**
Totali i zërave jashtë bilancit	**21,488,246**	**-**	**-**	**21,488,246**	**21,488,246**

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Metodologjitë e vlerësimit të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë

Më poshtë janë metodologjitë dhe supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta te instrumenteve financiare të mësipërme të cilat nuk regjistrohen dhe maten me vlerën e drejtë në pasqyrat financiare të Bankës. Këto vlera të drejta ishin llogaritur vetëm për qëllime të zbulimit. Metodologjitë dhe supozimet e mëposhtme lidhen vetëm me instrumentet në tabelat e mësipërme dhe, si të tilla, mund të ndryshojnë nga teknikat dhe supozimet e shpjeguara në Shënimin 6 (xi).

Hua dhe paradhënie për klientët
Huatë dhe paradhëniet janë paraqitur neto nga provizionet për zhvlerësim. Portofoli i kredisë së Bankës ka një vlerë të drejtë afërsisht të barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të natyrës së luhatshme të normave të interesit, me kreditë që riçmohen brenda ciklit një vjeçar, me përjashtim të një grupi kredish të dhëna në vitin 2008 të cilat janë dhënë pa një dysheme minimale e aplikueshme.

Të arkëtueshmet e qirasë financiare
Kontratat e qirasë financiare kanë një vlerë të drejtë që është e përafërt me vlerën e tyre kontabël. Afati mesatar i këtyre kontratave është më tepër afatmesëm ose afër maturimit dhe me normë interesi të ndryshueshme, e cila riçmohet brenda ciklit një vjeçar.

Detyrime ndaj klientëve
Vlera e drejtë e detyrimeve ndaj klientëve është vlerësuar duke përdorur teknikën e skontimit të fluksit monetar, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturime dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Borxhi i varur
Vlera e drejtë e borxhit të varur përafrohet me vlerën nominale të borxhit. Borxhi i varur përdoret si input i nivelit 3 në hierarkinë e vlerës së drejtë.

Pozicionet jashtë bilancit
Vlera e drejtë e vlerësuar e pozicioneve jashtë bilancit bazohet në çmimet e tregut për instrumente të ngjashme ose në modele të skontuara të flukseve monetare, siç shpjegohet më sipër, të cilat përfshijnë elementin e rrezikut të kredisë nëpërmjet faktorit të skontimit.

Tabela e mëposhtme tregon një analizë të instrumenteve financiare të regjistruara me vlerën e drejtë sipas nivelit të vlerës së drejtë hierarkie:

Aktive financiare				**31 dhjetor 2023**
	Niveli 1	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Investime në letrat me vlerë të borxhit VDATGj	8,171,253	19,542,023	-	**27,713,277**
Totali i aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë	**8,171,253**	**19,542,023**	**-**	**27,713,277**

Aktive financiare				**31 dhjetor 2022**
	Niveli 1	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Investime në letrat me vlerë të borxhit VDATGj	8,965,784	23,579,397	-	**32,545,181**
Totali i aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë	**8,965,784**	**23,579,397**	**-**	**32,545,181**

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Për qëllime të matjes, SNRF 9 "Instrumentet financiare: Njohja dhe matja", klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: a) instrumentet e borxhit me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATGj dhe (b) aktivet financiare me kosto të amortizuar.
Më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, të gjitha instrumentet financiare maten me koston e amortizuar, me përjashtim të investimeve në letra me vlerë të cilat maten me vlerën e drejtë.

	31 dhjetor 2023			31 dhjetor 2022		
	Vlera kontabël	**Kosto Amortizuar**	**VDATGj**	**Vlera kontabël**	**Kosto Amortizuar**	**VDATGj**
Aktivet						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	**20,547,198**	20,547,198	-	17,779,996	17,779,996	-
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	**14,213,819**	14,213,819	-	14,954,227	14,954,227	-
Huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare	**894,030**	894,030	-	627,752	627,752	-
Aktive e tjera	**1,685,703**	1,685,703	-	680,369	680,369	-
Instrumentet e borxhit në VDATGj	**27,713,277**	-	27,713,277	32,545,181	-	32,545,181
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	**10,484,224**	10,484,224	-	3,151,358	3,151,358	-
Hua dhe paradhënie për klientët	**93,413,612**	93, 413,612	-	99,925,011	99,925,011	-
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	**1,540,095**	1,540,095	-	1,232,223	1,232,223	-
Total i aktiveve	**170,491,958**	**142,778,681**	**27,713,277**	**170,896,117**	**138,350,936**	**32,545,181**
Detyrimet						
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	**2,166,715**	2,166,715	-	8,636,055	8,636,055	-
Detyrime ndaj klientëve	**148,343,661**	148,343,661	-	147,376,492	147,376,492	-
Detyrime të tjera	**2,819,846**	2,819,846	-	1,874,217	1,874,217	-
Totali i detyrimeve	**153,330,222**	**153,330,222**	**-**	**157,886,764**	**157,886,764**	**-**

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes direkte ose indirekte që vjen nga një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, si dhe nga faktorë të jashtëm të ndryshëm nga rreziqet e kreditit, të tregut dhe të likuiditetit, si ato që rrjedhin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe standardet përgjithësisht të pranuara të sjelljes së korporatës. Rreziqet operacionale lindin nga të gjitha operacionet e Bankës dhe përballen nga të gjitha entitetet.
Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me efektivitetin e përgjithshëm të kostos dhe të shmangë procedurat e kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.
Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i është caktuar menaxhmentit të lartë brenda çdo njësie biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve;
- pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe kërkesat e tjera ligjore;
- dokumentacionin e kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale me të cilat përballen, dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuara;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe masat e propozuara korrigjuese;
- zhvillimi i planeve të emergjencës;
- trajnim dhe zhvillim profesional;
- standardet etike dhe të biznesit; dhe
- zbutja e rrezikut, duke përfshirë sigurimin kur kjo është efektive

Pajtueshmëria me standardet e Bankës mbështetet nga një program rishikimesh periodike të ndërmarra nga struktura specifike të rrezikut operacional si dhe nga auditimi i brendshëm.

(g) Rreziku i pajtueshmërisë

Rreziku i pajtueshmërisë përfshin rrezikun e pajtueshmërisë rregullatore dhe ligjore. Rreziku i pajtueshmërisë është rreziku që Banka pëson rrezik financiar ose reputacional përmes vendosjes së gjobave ose penaliteteve si rezultat i mosrespektimit të ligjeve, rregullave dhe rregulloreve në fuqi dhe praktikave të mira të tregut (përfshirë standardet etike). Funksioni i pajtueshmërisë së Bankës kërkon në mënyrë proaktive të përmirësojë menaxhimin e rrezikut të përputhshmërisë dhe kuadrin mbështetës të kontrollit. Banka operon në një treg ku ka një nivel të konsiderueshëm të aktivitetit të ndryshimeve rregullatore, prandaj, rreziku i pajtueshmërisë është një fushë kyçe e fokusit për menaxhmentin e lartë. Funksioni i pajtueshmërisë monitoron këtë rrezik duke iu referuar metrikës përkatëse për Bankën, rishikimit të raporteve dhe vlerësimeve të incidentit, vlerësimeve të rrezikut dhe kontrollit që kanë të bëjnë me linjat e para dhe të dyta të funksioneve të mbrojtjes, rezultatet e vlerësimeve rregullatore, ndjekja e risive që vijnë nga pocesi i mbikqyrjes ligjore dhe rishikimi i rezultateve të auditimit të brendshëm dhe raporteve të auditimit të jashtëm. Përmirësimi i kontrolleve kryhet në kohën e duhur.

(h) Menaxhimi i kapitalit

Objektivat kryesore të politikës së menaxhimit të kapitalit të Bankës janë të sigurojë që Banka të jetë në përputhje me kërkesat e imponuara nga jashtë për kapital dhe ruan vlerësime të forta krediti dhe raporte të shëndetshme kapitali për të mbështetur biznesin e saj dhe për të maksimizuar vlerën e aksionerëve. Banka menaxhon strukturën e saj të kapitalit dhe bën rregullime në të në përputhje me ndryshimet në kushtet ekonomike dhe karakteristikat e rrezikut të aktiviteteve të saj. Për të ruajtur ose rregulluar strukturën e kapitalit, Banka mund të rregullojë shumën e pagesës së dividendit për aksionarët, t'u kthejë kapitalin aksionarëve ose të emetojë letra me vlerë të kapitalit. Megjithatë, tre vitet e fundit Banka e Shqipërisë i ka ndaluar bankat të shpërndajnë divident.

41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(h) Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)

Kapitali Rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, ndër masat e tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori shqiptar, Banka e Shqipërisë ("BSH"), e cila në fund përcakton kapitalin ligjor që kërkohet për të mbështetur biznesin e saj. Rregullorja "Për mjaftueshmërinë e kapitalit" është nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", dhe ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Ligji Bankar i Republikës së Shqipërisë".

Raporti i mjaftueshmërisë së Kapitali

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ("RMK") është raporti i kapitalit rregullator ndaj totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, i shprehur në përqindje. Raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%.

Ekspozimet e ponderuara sipas rrezikut (EPR)

Aktivet e ponderuara me rrezik llogariten si një shumë e sa vijon:

• Ekspozimet e ponderuara me rrezik të aktiveve brenda dhe jashtë bilancit të cilat ponderohen sipas qasjes së standardizuar të rregullores së BSH-së për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit". Sipas kësaj metode të gjitha ekspozimet dhe ekspozimet e mundshme grupohen në kategori të caktuara ekspozimi dhe brenda secilës prej tyre në grupe më të vogla sipas rrezikut që lidhet me to.

• Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun e tregut
• Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun operacional, duke përdorur metodën e treguesit bazë

Shtesat makroprudenciale të kapitalit në vitin 2023 ishte në nivelin 2% (2022: 1.5%). SIST për bankat me rëndësi sistemike është 0.5%. Sipas rregullores së Bankës, raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%. Banka është në përputhje me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit më 31 dhjetor 2023 dhe 2022:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Kapitali i nivelit te parë	21,639,429	19,174,815
Instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë	774,945	-
Kapitali rregullator	**22,414,374**	**19,174,815**
Aktivet e ponderuara me rrezik	**114,642,330**	**118,009,451**
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	19.55%	16.25%
Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit të kërkuar	12.00%	12.00%

Deri më 31 dhjetor 2023, borxhi i varur është përfshirë në llogaritjen e kapitalit rregullator Nivelit të Dytë.

Banka i bëri një kërkesë zyrtare bankës qendrore për përfshirjen e borxhit të varur në kapitalin e nivelit II më 28 dhjetor 2023, që është para përfundimit të periudhës raportuese. Banka konsideroi se provat e kushteve të miratimit rregullator ekzistonin në fund të periudhës raportuese dhe ajo kishte bazë të fortë për të besuar se miratimi ishte praktikisht i sigurt. Miratimi u mor në 25 janar 2024, i cili, edhe pse pas periudhës raportuese, dha konfirmim të mëtejshëm se kushtet për përfshirjen ishin përmbushur që nga data e raportimit.

Në datën 31 dhjetor 2023, fitimi për periudhen 6 mujore që përfundon më 30 qershor 2023 në shumën prej 1.597.460 mijë lekësh është përfshirë në kapitalin e Nivelit të Parë pas rishikimit të audituesit të çertifikuar dhe me miratim nga rregullatori. Gjysma e dytë e fitimit të vitit aktual përfshihet si element i kapitalit të Nivelit të Parë pasi pasqyrat financiare janë çertifikuar dhe raportuar tek rregullatori dhe pasi çdo dividend i ndërmjetëm (i pjesshëm) i paguar gjatë vitit, taksat dhe detyrimet e tjera mbi fitimin janë zbritur. Pas përfshirjes së fitimit të vitit aktual, Drejtimi vlerëson raportin e përshtatshmërisë së kapitalit në nivelin 20.64% më 31 dhjetor 2023 (2022: 17.09%).

otpbank

Raporti Vjetor 2023

